


Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Prill
2021



Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës

A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë

Organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb të Kosovës – Në mes të perceptimit dhe prezantimit

Partitë politike të serbëve të Kosovës në sistemin politik të Kosovës: Nga pluralizmi deri te monizmi

Qëndrimet e Serbëve të Kosovës mbi institucionet e sigurisë

Qasshmëria e institucioneve për qytetarët në Kosovë

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Analiza e gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

Titulli i hulumtimit: Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Botues: KFOS

Për botuesin: NGO AKTIV, FDMC

Autorët: Igor Markoviq, Boban Simiq

Gjuha origjinale në të cilën është punuar analiza është gjuha Serbe

Përkthimi në gjuhën shqipe: Xhenana Azizi

Dizajn: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): tedel (100)

Ky botim u realizua në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me organizatat OJQ AKTIV dhe FDMC. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.

Viti i botimit: 2021

PËRMBAJTJA

01.

HYRJE	6
Rreth hulumtimit	6
Rreth partnerëve të projektit	6

02.

PËRMBLEDHJE	8
Konteksti	8
Metodologjia e hulumtimit	8
Gjetjet kyçe	9
Rekomandimet kyçe	9

03.

SERBËT E KOSOVËS NË PROCESIN E DIALOGUT	10
Një rrugë e lakuar drejt dialogut të (Brukselit)	10
Parahistoria e Dialogut të Brukselit	10
Kronologjia e Dialogut të Brukselit	12
Trekëndëshi i bisedimeve: Prishtina, Beogradi dhe Brukseli	15
Sukseset dhe pengesat në rrugën e normalizimit	17
Qëllimi dhe metodologjia e hulumtimit	19
Dialogu nga perspektiva e serbëve të Kosovës: perceptimet dhe trendet	20
Rishikimi i rrjedhës aktuale të dialogut të Brukselit: banorët dhe ekspertët	21
E ardhmja e dialogut të Brukselit: dëshirat dhe frika	30
Pozicionimi i komunitetit serb të Kosovës në procesin e dialogut: përjashtimi dhe keqkuptimi?	34

04.

REKOMANDIME	36
--------------------	-----------

1. Hyrje

Rreth hulumtimit

Ky hulumtim synon të plotësojë njërin nga aspektet e temave kërkimore në kuadër të projektit OPEN, i cili ka për qëllim të masë se sa është i hapur komuniteti serb të Kosovës. Hulumtimi do të përqendrohet në dimensione të ndryshme të dialogut, d.m.th. në procesin e normalizimit midis Beogradit dhe Prishtinës, me theks të veçantë në ndikimin dhe pasojat praktike që pati në këtë komunitet jo-shumicë. Më saktësisht, ky hulumtim do të përpiqet të identifikojë avantazhet dhe disavantazhet e vetë procesit nga perspektiva e komunitetit serb, dhe në dritën e marrëdhënieve bashkëkohore politike, ekonomike, kulturore dhe ndëretnike në Kosovë, si dhe dialogut midis Beogradit zyrtar dhe Prishtinës. Në këtë kontekst, me një qasje gjithëpërfshirëse të hulumtimit dhe metodave do të ofrohet një pasqyrë e perceptimeve të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës në lidhje me gjithëpërfshirjen, efektivitetin, transparencën dhe të ardhmen e procesit të dialogut. Gjithëpërfshirja e qasjes bazohet në faktin se nevojiten kërkime të hollësishme dhe relevante, të cilat do të bëhen pika fillestare për identifikimin dhe hartëzimin e qëndrimeve dhe nevojave kryesore të këtij komuniteti. Rezultatet e hulumtimit do të tregojnë si rrjedhojë faktorët kryesorë dhe dimensionet e procesit të dialogut të cilit vendimmarrësit duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë, veçanërisht ata që krijojnë strategji dhe politika të drejtuara kah marrëdhëniet midis Prishtinës dhe Beogradit. Përveç krijimit të një baze për të ndikuar në vendimmar-

rje, studimi do të synojë gjithashtu të informojë publikun e gjerë për nevojat e komunitetit serb të Kosovës dhe të shohë rolin e tyre në procesin e dialogut, pra, normalizimin e marrëdhënieve.

Rreth partnerëve të projektit

OJQ AKTIV është një organizatë joqeveritare që kërkon të inkurajojë pjesëmarrjen qytetare përmes komunitetit në fushat e zhvillimit ekonomik, kulturor dhe shoqëror. Prandaj, projektet dhe puna në rajon pasqyrojnë një qasje holistike në zgjidhjen e problemeve dhe një besim të fuqishëm në gjithëpërfshirjen e komunitetit dhe pjesëmarrjen aktive në jetën qytetare. Duke reflektuar qasjen e saj shumëpalëshe, projektet e OJQ AKTIV kanë qenë jashtëzakonisht të larmishme dhe të zgjeruara duke përfshirë projekte të përqendruara në fuqizimin e kapacitetit të institucioneve publike lokale, rritjen e qasjes së grupeve të cenushme brenda Kosovës në mekanizmat gjyqësorë si dhe çështjet e sundimit të ligjit. Me rritjen e pjesëmarrjes së AKTIV-it në komunitetin lokal, si dhe thellimit të bashkëpunimit me organizata të tjera të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare dhe sektorin publik në nivelin lokal dhe qendror, AKTIV arriti që me projektet e tij të zgjerojë shtrirjen dhe mbulimin. Kështu, AKTIV kërkon të mundësojë pjesëmarrje kuptimplote të komunitetit serb të Kosovës në nxitjen e një të ardhme paqësore dhe të prosperuar në rajon, ku individë dhe institucione të fuqizuara të komuniteteve të hapura dhe aktive

kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës përmes procedurave të hapura, transparente dhe demokratike, duke respektuar të drejtat e njeriut.

Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim multi-etnik (FDMC) është një organizatë e shoqërisë civile që synon të promovojë vlerat evropiane dhe procesin e integritimit evropian në Kosovë. FDMC është gjithashtu një organizatë e pavarur, jo-fitimprurëse që promovon zhvillimin e shoqërisë civile, të drejtave të njeriut dhe komuniteteve mbi baza demokratike. FDMC bashkëpunon me grupe të ndryshme etnike përmes proceseve/aktiviteteve më të vogla konsultative. Parimet kryesore të FDMC janë toleranca, krijimi i partneriteteve me organizata të tjera (nga komuniteti shumicë), si dhe me njerëz, që paraqesin bazën dhe vlerën kryesore të kësaj organizate. Aktivitetet e FDMC synojnë: fuqizimin e sektorit të OJQ-së, sigurimin e mbështetjes teknike dhe informacionit për qeveritë lokale dhe qytetarët në fushën e rrjetëzimit, promovimit të kulturës dhe avokimit të OJQ-ve në publik, rrjetëzimin e OJQ-ve dhe koordinimin e OJQ-ve në projekte të përbashkëta, ofrimin e shërbimeve të tilla si informimi publik, dialogu dhe procesi për pajtimin e komuniteteve në Kosovë. FDMC gjithashtu promovon bashkëpunimin midis OJQ-ve dhe institucioneve në nivelin qendror.



Rezultatet e hulumtimit do të tregonin si rrjedhojë faktorët kryesorë dhe dimensionet e procesit të dialogut të cilit vendimmarrësit duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë, veçanërisht ata që krijojnë strategji dhe politika të drejtuara kah marrëdhëniet midis Prishtinës dhe Beogradit

2. Përmbledhje

Konteksti

Procesi i bisedimeve shumëvjeçare të zhvilluara midis Beogradit dhe Prishtinës kaloi nëpër disa faza që përcaktonin në mënyrë të konsiderueshme kontekstin aktual në të cilin zhvillohet jeta politike në Kosovë. Ndryshimet në formatin e dialogut, si dhe të ndërmjetësve të tij, për një periudhë prej dy dekadash nuk ka krijuar baza për marrëdhënie të qëndrueshme ndëretnike dhe marrëdhëniet midis dy palëve negociuese. I ngjyrosur nga ndikimi i pragmatizmit politik dhe nën ndikimin e rrëfimeve nacionaliste, dhe pasivitetit të kohëpaskohshëm dhe pavendosmërinë e ndërmjetësuesve, dialogu ende vazhdon dhe është një proces për të cilin nuk është e qartë nëse ka një qëllim përfundimtar.

Pas dështimit të zbatimit të planit të Ahtisaarit, Bashkimi Evropian mori përsipër ndërmjetësimin në bisedime. Nënshkrimi i marrëveshjeve teknike që ofronin zgjidhje për tejkalimin e problemeve specifike i paraprinë dialogut në nivelin më të lartë politik. Marrëveshja e Brukselit, si një dokument që supozohej të hapte rrugën për një zgjidhje gjithëpërfshirëse të problemeve që pengojnë avancimin më të shpejtë në rajon dhe në rrugën e integritimit evropian, mbeti e pazbatuar, si shumica e marrëveshjeve të nënshkruara midis Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel. Ndërprerjet në procesin e dialogut e pamundësuan vazhdimësinë e tij të qëndrueshme dhe, përpjekjet e fundit për ta ringjallur atë u iniciuan nga Uashingtoni.

Në gjithë këtë, perceptimet dhe qëndrimet e serbëve të Kosovës në lidhje me vendimet që ndikuan drejtpërdrejt nuk u studiuan dhe analizuan mjaftueshëm. Në rrethana të tilla, ishte e nevojshme të bëhej një studim i thelluar i qëndrimeve, interesave dhe aspiratave të komunitetit serb të Kosovës mbi pasojat dhe implikimet e zbatimit të vendimeve të marra gjatë procesit të bisedimeve, përfshirë përcaktimin e së ardhmes së dialogut.

Metodologjia e hulumtimit

Partnerët që zhvilluan hulumtimin organizuan gjithsej tetë grupe të fokusit që u mbajtën në mënyrë të barabartë si në veri ashtu edhe në jug të lumit Ibër. Në mënyrë që hulumtimi të përfshijë informacion të thelluar, u realizuan dymbëdhjetë intervista ekspertësh me akterë kyç nga komuniteti serb i Kosovës, që posedojnë njohuri përkatëse në lidhje me procesin e dialogut, si dhe fushat e lidhura ngushtë me temën e këtij hulumtimi.

Përveç aktiviteteve hulumtuese të kryera nga partnerët që u morën me çështjen e dialogut, një anketë e opinionit publik u organizua në kuadër të nismës OPEN. Kjo metodë përfshiu 600 të anketuar, pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, dhe u hulumtuan qëndrimet nga fushat me rëndësi dhe interes për këtë komunitet jo-shumicë. Ndër të tjera, tema e dialogut ishte pjesë e spektrit kërkimor, dhe rezultatet e anketës u përfshinë dhe u prezantuan në këtë punim. Qasja metodologjike në fjalë synonte të inkurajonte serbët e Kosovës që të flasin hapur dhe lirshëm për pasojat e procesit të bisedi-

meve midis Prishtinës dhe Beogradit, duke iu ofruar mundësi për të dhënë propozime dhe sugjerime për modifikimin ose ndryshimin e tij të plotë.

Gjetjet kyçe

Me realizimin e aktiviteteve hulumtuese u konstatua që pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës ndajnë pikëpamje rreth ndikimit të procesit të bisedimeve midis Prishtinës dhe Beogradit në jetën e tyre të përditshme. Gjetjet kryesore të nxjerra gjatë hulumtimit treguan se nga këndvështrimi i këtij komuniteti:

- dialogu kishte një ndikim përgjithësisht negativ në jetën e serbëve në Kosovë;
- procesi i dialogut kishte mungesë transparence dhe informacioni objektiv në lidhje me të;
- përfaqësimi i interesave autentikë të komunitetit nuk ekzistonte, për shkak të natyrës jo-përfshirëse të bisedimeve (p.sh. mungesa e përfaqësuesve serbë të Kosovës si një subjekt i veçantë i bisedimeve);
- Beogradi është i vetmi negociator në të cilin komuniteti ka besim;
- është e nevojshme të vazhdohen bisedimet për tri tema (të reja) kyçe: zgjidhja e çështjes së të zhdurve dhe të kidnapuarve, si dhe kthimi i qëndrueshëm, përsheptimi i shqyrtimit të çështjeve të pazgjidhura juridike-pronësore dhe krijimi i mbrojtjes së qëndrueshme të trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë.

Rekomandimet kyçe

- Vazhdimi i dialogut duhet të përfshijë përfaqësues serbë të Kosovës dhe procesi i bisedimeve duhet të jetë plotësisht transparent.
- Serbëve të Kosovës duhet t'u jepet më shumë hapësirë dhe mundësi për të marrë vendime në nivelet lokale dhe qendrore, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe të pakicave.
- Temat me prioritet të komunitetit të nxjerra gjatë hulumtimit duhet të përfshihen në agjendën e vazhdimit të dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës, me garanci ndërmjetësuese dhe monitorim të zbatimit nga BE.
- Çdo zgjidhje e negociuar nga Prishtina dhe Beogradi duhet të jetë rezultat i konsultimit me popullatën lokale, me mungesë të zbatimit të zgjidhjeve të imponuara dhe jo transparente.

3. Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Një rrugë e lakuar drejt dialogut të (Brukselit)

Parahistoria e Dialogut të Brukselit

Me nënshkrimin e Marrëveshjes ushtarako-teknike në Kumanovë¹ më 9 qershor 1999, në shkallë të gjerë iu dha fund konfliktit të armatosur dhe në qarqet ndërkombëtare u konsiderua se ky dokument vendosi paqen e shumëpritur në Kosovë. Sidoqoftë, formimi i një administrate ndërkombëtare në territorin e Kosovës ka sjellë me vete sfida të mëdha që do të shkaktojnë ndryshime të papritura dhe do krijojnë një kornizë të zhvillimeve të mëtejshëm të marrëdhënieve ndëretnike dhe plejadën e forcave politike në Kosovë (dhe në vetë rajonin). Angazhimi i pamjaftueshëm i misionit paqeruajtës ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara² (themeluar me Rezolutën 12/44) për të ofruar sigurinë në Kosovë për të gjithë qytetarët e Kosovës ka rezultuar në zhvendosjen e drejtpërdrejtë të rreth 242,000 jo-shqiptarëve nga Kosova³, që u pasua nga incidente të pazgjdhura të dhunshme, cenim dhe shkatërrim të pronës private dhe publike, si dhe vrasje⁴. Pasojat shkatërruese të luftës në të cilën,

sipas vlerësimeve të ndryshme (direkt ose indirekt) rreth 13,535 njerëz humbën jetën (dhe u zhdukën)⁵, pothuajse dy dekada kanë paralizuar procesin e rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike, kthimin e personave të zhvendosur, por gjithashtu krijimin e një periudhe më të gjatë të stabilitetit politik dhe marrëdhënieve rajonale bazuar në mungesën e diskurseve nacionaliste.

Pavarësisht nga fakti se Marrëveshja e Kumanovës përmbante elementë të një marrëveshje paqësore, një paqe e qëndrueshme dhe afatgjate u bë viktimitë e rrethanave komplekse historike dhe politike, të cilat datojnë që nga periudha e shpërbërjes së Jugosllavisë. Prania e forcave ndërkombëtare nuk frymëzoi besim tek anëtarët e komuniteteve jo-shumicë, ndërsa pasiviteti në drejtim të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë dhe parandalimit të konflikteve më të gjera arriti kulmin e tij gjatë trazirave të dhunshme në mes të marsit 2004. Përkundër ekzistencës së pikëpamjeve të ndryshme dhe shpesh tërësisht kontradiktore mbi arsyen dhe shkakun e shpërthimit të trazirave të marsit, kryesisht ndaj serbëve të Kosovës, shkakto pasoja të paparashikueshme për bashkëjetesën e mëtejshme të komuniteteve në Kosovë. Sipas vlerësimeve të OSBE-së, më 17, 18 dhe 19 mars u vranë 19 persona (11 shqiptarë të Kosovës dhe 8

1 Vlada Republike Srbije, Vojno-tehnički sporazum, e qasshme në: <https://www.srbija.gov.rs/kosovo-metohija/?id=19947>

2 United Nations, United Nations Resolution, 10.7.1999, e qasshme në: <https://unmik.unmissions.org/united-nations-resolution-1244>

3 Vlada Republike Srbije, Interno raseljena i prognana lica sa Kosova i Metohije, e qasshme në: <https://www.srbija.gov.rs/kosovo-metohija/20031>

4 Tim Judah, Kosovo: What Everyone Needs to Know, Kosovo University Press, 2008, fq. 93-107.

5 Fond za humanitarno pravo, 31.600 dokumenata nedvosmisleno potvrđuje smrt ili nestanak 13.535 osoba tokom rata na Kosovu, 2.6.2015, qasshme në: <http://www.hlc-rdc.org/?p=28185>

serbë)⁶, ndërsa raportet e Kombeve të Bashkuara thonë se 954 njerëz u plagosën gjatë incidenteve të dhunshme⁷. Nga ana tjetër, u shkatëruan dëme të konsiderueshme materiale me karakter civil dhe kulturo-fetar: rreth 730 shtëpi (kryesisht në pronësi të serbëve të Kosovës) u shkatëruan ose dëmtuan, 36 kisha dhe manastire ortodokse u shkatëruan ose dëmtuan (dy manastire nën mbrojtjen e UNESCO-s u dëmtuan gjithashtu), ndërsa dëme të konsiderueshme u shkaktuan mjedisve të UNMIK-ut, KFOR-it dhe Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse⁸. Vlerësohet se rreth 4,000 jo-shqiptarë u detyruan me forcë të linin shtëpitë e tyre¹⁰. Si rezultat i ngjarjeve të marsit, dhuna u përhap përtej territorit të Kosovës dhe pas protestave masive dhe të dhunshme, xhamitë në Beograd dhe Nish u dogjën.¹¹

Në dritën e ngjarjeve të marsit dhe situatës së paqëndrueshme politike në Kosovë dhe aspiratave dhe dëshirave të shqiptarëve të Kosovës për krijimin e një shteti të pavarur, bisedimet në niv-

elin e bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjet e mundshme të një pakoje problemesh dhe sfidash filluan. Megjithëse kishte sugjerime të ndryshme në publik për rezultatin e mëtejshëm të *Nyjes Gordiane të Kosovës*, iniciatorët e një hapi më konkret që synojnë zgjidhjen e një problemi të kahershëm në *oborin e shtëpisë së Evropës* e gjetën veten në Grupin (joformal) të Kontaktit (SHBA, MB, Rusi, Francë dhe Itali) dhe në Kombet e Bashkuara. Për atë qëllim, në mes të nëntorit 2005, OKB caktoi ish-Presidentin finlandez Martti Ahtisaari si të dërguar special për statusin e ardhshëm të Kosovës. Gjë që procesin e zgjidhjes së situatës së konfliktit do ta lëvizte, në atë moment, nga pika e vdekjes. Detyra e të dërguarit ishte të bënte një plan gjithëpërfshirës, të detajuar dhe gradual për zgjidhjen (përfundimtare) të statusit të Kosovës, duke respektuar të drejtat dhe nevojat e të gjitha komuniteteve në Kosovë¹².

Pas bisedimeve të pasuksesshme në nivelin teknik, një dialog midis Beogradit dhe Prishtinës u mbajt në vitin 2006 në nivelin më të lartë politik¹³. I cili më vonë do të marrë epitetin e bisedimeve të Vjenës, të përfaqësuar në takime të ndërmjetësuar me pjesëmarrje të niveleve më të larta të qeverisë, nga presidentët dhe kryeministrat e të dy palëve negociuese, të përfaqësuesit e stafit diplomatik (të Serbisë) dhe forcave të opozitës (të Kosovës). Megjithëse të ndërmjetësuar nga KB ose i Dërguari Special, bisedimet nuk dhanë fryt, duke pasur parasysh faktin se Beogradi hodhi poshtë propozimin e Martti Ahtisaari në shkurt 2007.¹⁴ Qëndrimet e kundërshtuara në mënyrë diametrike të palëve u përplasën

6 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Misioni në Kosovë, Katër vjet më vonë: Rezume e rasteve të Trazirave të Marsit 2004 para Sistemit të Drejtësisë Penale në Kosovë, 2008, e qasshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/c/4/32701.pdf>

7 United Nations Security Council, Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, 30.4.2004, e qasshme në: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65B-FCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/kos%20S2004%20348.pdf>

8 Gjithashtu, 65 anëtarë të forcës policore ndërkombëtare, 58 anëtarë të SHPK-së dhe 61 anëtarë të stafit pësuan lëndime të rënda.

9 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Misioni në Kosovë, Katër vjet më vonë: Rezume e rasteve të Trazirave të Marsit 2004 para Sistemit të Drejtësisë Penale në Kosovë, 2008, e qasshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/c/4/32701.pdf>

10 B92, 11 years since "March Pogrom" of Serbs in Kosovo, 17.3.2015, e qasshme në: https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2015&mm=03&dd=17&nav_id=93505

11 TRT bosanski, Dan džamija u Srbiji: Prije jedanaest godina gorjele džamije u Beogradu i Nišu, 18.3.2015, e qasshme në: <https://www.trt.net.tr/bosanski/region/2015/03/18/dan-dz-amija-u-srbiji-prije-jedanaest-godina-gorjele-dz-amije-u-beo-gradu-i-nisu-40455>

12 United Nations, Secretary General appoints former president Martti Ahtisaari of Finland as Special Envoy for Future Status Process for Kosovo, 15.11.2005, e qasshme në: <https://www.un.org/press/en/2005/sga955.doc.htm>

13 Vreme, Srpska karta na zelenoj čoji, 27.7.2006, e qasshme në: <https://www.vreme.com/cms/view.php?id=460495>

14 Vreme, Propali bečki pregovori, 15.3.2007, e qasshme në: <https://www.vreme.com/cms/view.php?id=491314>

për një faktor kyç të mosmarrëveshjes, siç thotë vetë titulli i punës së nismës - statusi: derisa Prishtina nuk pranoi asgjë përveç pavarësisë së plotë, vija e kuqe për Beogradin ishte autonomia e zonës. Për më tepër, qëndrimet për çështjet e decentralizimit, të drejtat e komunitetit, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare, çështjet ekonomike, të cilat ishin në qendër të negociatave në Vjenë, ishin larg nga ato konstruktive. Vetë propozimi në formën e një dokumenti që mban titullin e punës *Propozim gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës*¹⁵ përmban një sërë rekomandimesh që do të hapnin rrugën dhe do të lehtësonin kalimin nga status quo-ja- në një zgjidhje të qëndrueshme për statusin e Kosovës. Propozimi ofroi një bazë për mbrojtjen e të drejtave, identitetit dhe kulturës së komuniteteve jo-shumicë me një fokus në krijimin e një kornize për pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën publike.

Për shkak të mungesës së mbështetjes së plotë ndërkombëtare për planin e refuzuar të Ahtisaarit dhe mbështetjes së një pjese të caktuar të bashkësisë ndërkombëtare, Prishtina vendosi të ndërmerre një hap që do të ndryshonte në thelb situatën faktike në terren. Përkatësisht, më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë, siç thuhet shprehimisht, në përputhje me propozimin e *Planit të Ahtisaarit*¹⁶. Duke marrë si bazë planin, Prishtina hartoi Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës mbi parimet dhe masat e përcaktuara me këtë dokument. Si temë e bisedimeve të Vjenës, pakoja e të drejtave të parashikuara për komunitetet jo-shumicë e gjeti veten brenda kornizës ligjore dhe kështu pjesërisht siguroi materializimin e arritjeve të dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës:

- Kosova përcaktohet si një shtet multietnik dhe civil i të gjithë qytetarëve të saj, ku do të respektohet dhe sigurohet mbrojtja e kulturës, gjuhës dhe simboleve të komuniteteve jo-shumicë;

- përqindja/pjesëmarrja numerike e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë (dhe kështu edhe të serbëve të Kosovës) në organet institucionale në nivelin lokal dhe qendror, si dhe pjesëmarrja e tyre në proceset vendimmarrëse demokratike;
- përcaktohet mundësia e formimit të komunave me shumicë serbe dhe kështu mundësohet decentralizimi;
- janë krijuar zona të veçanta për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, pra mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si dhe fetare (Kisha Ortodokse Serbe) të serbëve të Kosovës.

Sidoqoftë, pavarësisht nga përpjekjet e bëra për të vendosur vazhdimësinë midis planit të Ahtisaarit dhe aktit të shpalljes së pavarësisë, zbatimi i parimeve të mësipërme vazhdoi me një ritëm të ngadaltë në vitet e para pas shpalesjes së tyre. Integrimi i serbëve në sistemin (e ri) të Kosovës u gjend në një ngushticë politike midis Beogradit dhe Prishtinës, dhe ky proces pengoi më tej progresin në fushat e demokratizimit, forcimit institucional, proceseve të pajtimit dhe ndërtimit të një shoqërie më tolerante multietnike. Mungesa e integritetit të pjesës veriore të Kosovës në sistemin e ri praktikisht ka paralizuar procesin e zbatimit të planit të Ahtisaarit në të gjithë Kosovën. Me fërkime të vazhdueshme midis Prishtinës dhe Beogradit, problemet e akumuluarra dhe të pazgjadhura që qëndronin në mes të palëve negociuese kërkuan vazhdimin e bisedimeve për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme.

Kronologjia e Dialogut të Brukselit

Dështimet në përpjekjet për të integruar pjesën veriore (me shumicë serbe) të Kosovës në sistemin ligjor dhe politik kanë kushtëzuar domosdoshmërinë e vazhdimin të dialogut. Ashtu si gjatë bisedimeve të Vjenës, iniciativa për fillimin e bisedimeve erdhi nga bashkësia ndërkombëtare. Hapësira për manovrim për rifillimin e dialogut u gjet menjëherë pas publikimit të opinionit këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për

¹⁵ United Nations Security Council, Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement, 26.3.2007, e qasshme në: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20168.Add1.pdf>

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli XIII, neni 143, e qasshme në: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Ustav1.pdf>

Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.¹⁷ Këtë herë, Bashkimi Evropian mori rolin udhëheqës nga KB, duke dashur kështu të kontribuojë në tejkalimin e mosmarrëveshjeve dhe barrierave që penguan marrëdhëniet midis Beogradit dhe Prishtinës. Gjegjesisht, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 9 shtator 2010 miratoi një rezolutë (64/298)¹⁸ që mundësoi vazhdimin dhe fillimin e dialogut me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Siç thuhet në rezolutën, qëllimi i raundeve të reja të bisedimeve është "të promovojnë bashkëpunimin, të bëjnë përparim në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe të përmirësojnë kushtet e jetesës së qytetarëve"¹⁹. Ajo që është thelbësore në mesazhet e njoftuara nga zyrtarët e BE-së, si dhe në vetë rezolutën, është që dialogu të përqendrohet në tre faktorë kryesorë - paqen, sigurinë dhe stabilitetin.

Pasi BE kushtëzoi procesin e integritimit evropian të Kosovës dhe Serbisë dhe e lidhi atë drejtpërdrejt me kornizën e sapo krijuar për bisedime, roli i saj si ndërmjetës në bisedime fitoi një rëndësi dhe peshë shtesë.²⁰ Pas konsultimeve përgatitore dhe vendosjes së bazës ligjore për vazhdimin e dialogut^{21,22}, bisedat e të ashtuquajturit nivelit teknik filluan më 9 mars 2011. Përfaqësuesit e ekipeve të ekspertëve të Prishtinës dhe Beogradit negociuan në nivelin e ekspertëve, të udhëhequr nga Edita Tahiri (Zëvendës Kryeministre e Kosovës dhe Ministre për Dialogun) dhe Borko Stefanoviq (Përfaqësues

Special i Beogradit për Dialogun). Nga fillimi i bisedimeve deri në 12 korrik 2012, delegacionet, në formatin teknik, arritën të formulojnë dhe të bien dakord rreth përmbajtjes së marrëveshjes në fushat që kërkonin hapa konkretë në zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë të dy palët:

- *Marrëveshja për lirinë e lëvizjes (2 korrik 2011)*
- *Marrëveshja për librat e regjistrit Civil (2 korrik 2011)*
- *Marrëveshja për shënimet kadastrale (2 korrik 2011)*
- *Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të diplomave (2 korrik 2011)*
- *Marrëveshja për vulat doganore (2 shtator 2011)*
- *Marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufirit (2 dhjetor 2011)*
- *Marrëveshja për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal (24 Shkurt 2012)*
- *Marrëveshja për zyrtarët ndërlidhës (19 tetor 2012, ripërtërirë më 30 maj dhe 4 dhjetor 2013)*

Duke marrë parasysh faktin se fushat për të cilat u bisedua ishin pjesërisht në fushën e çështjeve politike, lindi nevoja për të forcuar procesin e dialogut përmes ngritjes së nivelit të bisedimeve nga ato teknike në më të larta, pra politike. Përkundër faktit se nuk është e qartë nga lindi një iniciativë e tillë dhe kur lindi ideja e nevojës për të vendosur një dialog në nivel politik, çfarë mund të përcaktohet si një prag kohor/moment kur përfaqësimi i palëve në një nivel më të lartë u propozua është Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për normalizimin e marrëdhënieve²³ e cila Qeverisë ia delegoi kompetencat për të udhëhequr bisedimet me Beogradin. Nga ana tjetër, Beogradi nuk tregoi një ndryshim në formatin e bisedimeve në Bruksel me ndonjë dokument zyrtar. Duke filluar nga 19 tetor 2012, takimet në nivelin politik u kryesuan nga Kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë - Ivica Dačić dhe Hashim Thaçi.

17 International Court of Justice, Advisory opinion: Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in respect of Kosovo, 22.7.2010, e qasshme në: <https://www.icj-cij.org/public/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>

18 United Nations General Assembly, Resolution 64/298, 9.9.2010, e qasshme në: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/ROL%20A%20RES64%20298.pdf>

19 Ibid.

20 European Commission, Indicative Strategy Paper for Serbia (2014-2020), 2014.

21 Skupština Republike Kosovo, Rezolucija o dijalogu između Republike Kosovo i Republike Srbije, 10.3.2011, e qasshme në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_dialogun_midis_R.Kosoves_dhe_R.Serbise_2.pdf

22 Narodna Skupština Republike Srbije, Deklaracija Narodne skupštine Republike Srbije o aktuelnom stanju na Kosovu i Metohiji nakon jednostranih i nasilnih akata privremenih institucija samouprave u Prištini, član 6.b., Službeni glasnik Republike Srbije, 1.8.2011, qasshëm në: <http://www.pravno-informacioni-sistem.rs/SlGlasnikPortal/viewdoc?uuid=e6c46ed1-2e23-4f92-89fa-09e2b41e2d6a®acid=422134&doctype=reg>

23 Skupština Republike Kosovo, Rezolucija o normalizaciji odnosa između Republike Kosovo i Republike Srbije, 18.10.2012, qasshme në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_Marredhenive_Kosova_Serbia.pdf

Pika e kthesës në natyrën dhe formën e dialogut u interpretua si nevojë për të forcuar domethënien simbolike dhe praktike të procesit të dialogut dhe për t'i dhënë atij një notë politike. Në atë kuptim, me një vonesë në krahasim me Prishtinën, Beogradi miratoi më 13 janar 2013 *Platformën politike për bisedime me përfaqësuesit e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse në Prishtinë*, e cila më në fund zyrtarizoi karakterin e ri të bisedimeve.²⁴ Me dëshirën për të përmirësuar marrëdhëniet në fushat me rëndësi kryesore për procesin e normalizimit, bisedimet vazhduan për tema që vështirësuan jetën e qytetarëve të Kosovës për vite me radhë, dhe u lanë mënjënjë pikërisht për shkak të mungesës së komunikimit të drejtpërdrejtë midis palëve negociuese. Në mënyrë që diçka e tillë të realizohej, një kusht i domosdoshëm ishte përcaktimi i parimeve themelore mbi të cilat do të zhvillohet dialogu në nivelin politik. Dokumenti me titull punues *Marrëveshja e parë mbi normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës* u nënshkrua në 19 prill 2013.²⁵ Ky dokument i rëndësishëm kishte të bëjë me zgjidhjen e problemeve kyçe në procesin e integritimit të komunave në veri në sistemin juridik dhe politik të Kosovës, por edhe eliminimin e institucioneve paralele nga territori i Kosovës:

- themelimi i një Asociacioni të komunave me shumicë serbe
- integrimi i anëtarëve të strukturave të sigurisë së Serbisë në Kosovë në sistemin e Kosovës,
- krijimi i një qendre rajonale policore (me një komandant special) për katër komuna veriore (Mitrovica e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok),
- integrimi i organeve gjyqësore (në veri) në sistemin gjyqësor të Kosovës,
- përcaktoi mbajtjen e zgjedhjeve lokale në katër komuna në veri,
- përcaktoi parimet e mosndërhyrjes reciproke në rrugën e integritimit evropian, dhe
- njoftoi zgjidhjen e pengesave në fushën e telekomunikacionit dhe energjisë.

24 Vlada Republike Srbije, *Politička platforma za razgovore sa predstavnicima privremenih institucija samouprave u Prištini*, 13.1.2013, e qasshme në: https://www.srbija.gov.rs/extfile/sr/183065/politicka_platforma_kim2013_lat.pdf

25 Kancelarija za Kosovo i Metohiju, *Prvi sporazum o principima normalizacije odnosa između Beograda i Prištine*, 19/04/2013, në dispozicion në: <http://www.kim.gov.rs/p03.php>

Një marrëveshje që më vonë u dha epiteti e Brukselit paraqiti një hap të madh drejt tejkalimit të mangësive ekzistuese në marrëdhëniet midis Beogradit dhe Prishtinës, por gjithashtu i dërgoi një sinjal të qartë Bashkimit Evropian në lidhje me dëshirën e palëve negociuese për të avancuar në procesin e integritimit evropian duke gjetur zgjidhje të qëndrueshme. Shpallja e formimit të Komitetit të Zbatimit (i përcaktuar nga kjo marrëveshje) ka përhapur besimin se, ndryshe nga marrëveshjet teknike të nënshkruara më parë (zbatimi i të cilave ka qenë i ngadaltë), Marrëveshja e Brukselit do të kontribuojë në forcimin e përgjegjësisë së palëve nënshkruese.

Në valën e suksesit të nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, bisedimet e ndërmjetësuara nga BE vazhduan dhe marrëveshjet e miratuara qëllimi i të cilave ishte rregullimi ligjor i detyrimeve për të tejkaluar pengesat në fushat që kërkonin masa specifike janë:

- *Marrëveshja për telekomunikacion (8 shtator 2013)*
- *Marrëveshja për energjinë (2 shtator 2011)*
- *Marrëveshja për vizitat e zyrtare (7 tetor 2013)*
- *Marrëveshja për integrimin e strukturave të policisë (31 dhjetor 2013)*
- *Marrëveshja për drejtësi dhe gjyqësorin (9 shkurt 2015)*
- *Marrëveshja për shpërbërjen e të ashtuquajturës 'mbrojtja civile' (26 mars 2015)*
- *Marrëveshja për njohjen reciproke të policave (sigurimeve) të automjeteve (25 qershor 2015)*
- *Marrëveshja për certifikatat e produkteve farmaceutike (27 qershor 2015)*
- *Marrëveshja për njohjen reciproke të certifikatave (19 prill 2016)*
- *Marrëveshje për dizajnin e rivitalizimit të urës së Mitrovicës (8 qershor 2016)*

Në periudhën nga viti 2015 dhe 2018, u nënshkruan një numër planesh veprimi dhe konkluzione për zbatimin e marrëveshjeve të rena dakord. Sidoqoftë, për shkak të ngërçit në bisedime të shkaktuara nga futja e taksave të Kosovës për importet e mallrave nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina

na²⁶, puna për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të dakorduara u ndërpre plotësisht. Pas gati një viti e gjysmë që nga futja e taksave dhe pas presionit të konsiderueshëm nga bashkësia ndërkombëtare ato u shfuqizuan më 1 prill 2020²⁷. Sidoqoftë, ndërkohë, Shtetet e Bashkuara morën iniciativën për të ringjallur dialogun dhe ndërmjetësuan në bisedime midis Beogradit dhe Prishtinës. Rezultati i parë i kësaj initiative ishte *Marrëveshja për hekurudhat dhe autostradat* e nënshkruar më 14 shkurt 2020 në Mynih²⁸. Siç tregon edhe titulli i marrëveshjes, ajo kishte të bënte me rrjetëzimin e hekurudhës dhe infrastrukturën shoqërore midis Prishtinës dhe Nishit, si dhe ndërtimin e një autostrade midis dy qyteteve, me qëllim të forcimit të lidhjeve ekonomike dhe të komunikimit midis palëve negociuese. Në fund, si kulmi i përpjekjeve diplomatike të SHBA-së në fushën e normalizimit të marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, më 4 tetor të të njëjtit vit u nënshkrua *Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike (e ashtuquajtur Marrëveshja e Uashingtonit)*, e cila përfshinë detyrimet vijuese të të dy palëve:

- angazhimi për zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara më 14 shkurt,
- bashkëpunim me Korporatën Financiare Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar,
- hapjen dhe menaxhimin e vendkalimit të përbashkët Merdare,
- përgatitjen e një studimi të fizibilitetit për nevojat e ndarjes së kapaciteteve të liqenit të Ujmanit,
- hyrje në Zonën Mini-Shengen,,
- diversifikimi i furnizimit me energji,
- ripërtëritja e komunikimit ndërfetar, mbrojtja e ndërtesave fetare dhe zbatimimi i vendimeve gjyqësore në lidhje me Kishën Ortodokse Serbe,
- përsheptimi i përpjekjeve për të gjetur dhe

identifikuar mbetjet e personave të zhdukur,

- aplikimi i një moratoriumi një vjeçar mbi kërkesën e Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare nga njëra anë dhe bllokimi i fushatës së Serbisë për tërheqjen e njohjes së pavarësisë nga ana tjetër,
- si dhe tema tjera²⁹ të lidhura në mënyrë indirekte me marrëdhëniet e palëve negociuese me Shtetet e Bashkuara.³⁰

Megjithëse publiku përmendi faktin se natyra ligjore e vetë marrëveshjes është e diskutueshme, akterët më të rëndësishëm ndërkombëtarë e mirëpritën nënshkrimin e marrëveshjes si një nga hapat e rëndësishëm drejt kthimit të normalizimit të marrëdhënieve dhe nënshkrimit të një marrëveshje përfundimtare midis Beogradit dhe Prishtinës. Një nga hapat e parë drejt zbatimit të marrëveshjes ishte krijimi i zyrës së Korporatës Financiare për Zhvillim Ndërkombëtar në Beograd, hapja dhe menaxhimi i vendkalimit të përbashkët në Merdare, si dhe fillimi i fazës përgatitore për analizën për shpërndarjen e potencialeve materiale dhe energjetike të liqenit të Ujmanit.

Trekëndëshi i bisedimeve: Prishtina, Beogradi dhe Brukseli

Në periudhën e pasluftës, tre aktërë kryesorë ndërkombëtarë ndërmjetësuan në procesin e normalizimit të marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit: Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përkundër angazhimit proaktiv të këtyre tre subjekteve të marrëdhënieve ndërkombëtare në krijimin e një platforme të qëndrueshme për negociatën dhe zbatimin praktik të marrëveshjeve të nënshkruara, dhe detyrimet e ndërmarra, i gjithë procesi nuk pati shumë sukses. Gjatë bisedimeve të Vjenës dhe prezantimit të planit

26 Insajder, Vlada Kosova uvela takse od 100 odsto i na robu stranih kompanija koje imaju pogone u Srbiji, 28.12.2018, qasshme në: <https://insajder.net/sr/sajt/vazno/13010/>

27 Agencija Anadolu, Danas stupila na snagu odluka Vlade Kosova o ukidanju taksi BiH i Srbiji, 1.4.2020, e qasshme në: <https://www.aa.com.tr/ba/ekonomija/danas-stupila-na-snagu-odluka-vlade-kosova-o-ukidanju-taksi-bih-i-srbiji/1787498>

28 Slobodna Evropa, Srbija i Kosovo: Potpisani sporazumi o autoputu i železnici, 14.2.2020, e qasshme në: <https://www.slobodnaevropa.org/a/srbija-kosovo-sporazum-autoput-zeleznica/30434613.html>

29 Ndalimi i përdorimit të paqisjeve 5G nga furnizues jo të besueshëm, rritja e kontrollit të pasagjerëve ajrorë, vazhdimi i kthimit të pronës hebreje të viktimave të Holokaustit pa trashëgimtarë, puna në dekriminalizimin e homoseksualitetit në 69 vende, etiketimi i Hezbollahut si një organizatë terroriste, dhe njohja e ndërsjellë e Kosovës dhe Izraelit dhe hapja e ambasadave të palëve negociuese në Jerusalem.

30 N1 Info, Šta je potpisano – tekst sporazuma, 5.9.2020, e qasshme në: <http://rs.n1info.com/Vesti/a636581/Tekst-sporazuma-Beograd-Pristina.html>

të Ahtisaarit, mungesa e emëruesit më të ulët të përbashkët në interes të palëve negociuese luajti një rol të madh në dështimin e procesit. Pozicionet e qëndrueshme që Prishtina dhe Beogradi iu përmbajtën vetëm më tej kontribuan në mangësinë tashmë ekzistuese në formën e reputacionit të dobët dhe potencialit të ndërmjetësimit të KB (dhe të dërguarit të saj të posaçëm për bisedime).

Për shkak të ndërprerjes së komunikimit midis Beogradit dhe Prishtinës pas shpalljes së pavarësisë, Bashkimi Evropian, për hir të stabilitetit dhe prosperitetit në Ballkanin Perëndimor, vendosi të marrë primatin ndaj ndërmjetësimit në dialog, i cili gjithashtu do të përshpejtojë procesin e integritimit evropian të Serbisë dhe Kosovës. Ndërmjetësuesit e dialogut Ketrin Eshton dhe Federika Mogerini zhvilluan bisedime në nivelin politik, të cilat shpesh shoqëroheshin me keqpërdorim të dialogut për qëllime të brendshme politike në Serbi dhe Kosovë, ndërsa ngadalësuan zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Nga ana tjetër, mungesa e transparencës së procesit të dialogut u tregua nën kujdesin e BE-së, e cila më tej privoi legjitimitetin e bisedimeve në mesin e popullatës së Kosovës dhe Serbisë. Me predispozita të tilla, strategjia e dhënies së *karotës* (premtion të përshpejtojë procesin e integritimit në BE) dhe *shkopit* (ndalimi/ngadalësimi i mundshëm i procesit të integritimit evropian) nga Bashkimi Evropian, sipas Beogradit zyrtar dhe Prishtinës, nuk ka dhënë fryte. Për më tepër, BE, si ndërmjetësues në bisedime, nuk siguroi një mekanizëm pasues dhe adekuat të monitorimit të zbatimit të marrëveshjes, duke u lënë palëve negociuese hapësirë të mjaftueshme për të zvarritur, vonuar dhe refuzuar zbatimin e zotimeve. Pikërisht për arsyet e lartpërmendura, Brukseli në përpjekjen e tij dështoi të pozicionohej si një ndërmjetës me autoritetin e nevojshëm që procesi i normalizimit të ecte normalisht. Në fund, BE nuk ka përcaktuar qartë dhe zyrtarisht përmbajtjen, thelbin dhe qëllimin e procesit të normalizimit të marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit.

Që në fillim, Prishtina, si një palë negociuese, këmbënguli në qëndrimin që bisedimet të çojnë drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht në njohjen reciproke.

Sidoqoftë, presioni i bashkësisë ndërkombëtare e ktheu atë përsëri në tryezën e bisedimeve, duke qenë se para një skenari të tillë ishte e nevojshme të ndërmerreshin hapa të caktuar që përfundimisht do të çonin në njohje reciproke të vlefshme ndërkombëtarisht. Paqëndrueshmëria politike si një konstantë e skenës politike të Kosovës, e shprehur në mosmarrëveshjen e shpeshtë të subjekteve politike mbi përparësitë në procesin e dialogut, ka gjeneruar devijime në qëndrueshmërinë e qasjes në bisedime. Përveç kësaj, autonomia shpesh e kritikuar (dhe papërgjegjësia e pjesshme ndaj institucioneve të tjera të Prishtinës) në përfaqësimin e interesave të Kosovës nga Kryeministri (më vonë Presidenti) Hashim Thaçi, u perceptua si një aktivitet në kundërshtim me parimet e interesave shtetërore të Kosovës. Mungesa e vullnetit politik për të zbatuar marrëveshjet e arritura, veçanërisht ato që lidhen me formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, krijoi një atmosferë të mos ekzistencës së përgjegjësive për zotimet ndërkombëtare. Gjithashtu, njoftimet jo transparente, joformale dhe në disa vende plotësisht të paqarta për demarkacionin e mundshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë kanë dëmtuar më tej kredibilitetin e procesit në Kosovë dhe pjesërisht në Serbi. Në krahasim me Prishtinën, Beogradi i përmbahej me vendosmëri parimit që Kosova si një entitet territorial përfaqëson një krahinë autonome brenda sistemit juridiko-administrativ të Serbisë. Përkundër faktit se koncesionet e dhëna gjatë bisedimeve ishin në kundërshtim me Kushtetutën Serbe, shpesh (zyrtarisht) theksohej se të gjitha masat e marra ishin në përputhje të plotë me kornizën ekzistuese ligjore. Megjithatë Beogradi e refuzoi në mënyrë të qartë propozimin e Ahtisaarit, ai jo zyrtarisht pranoi parimet e përcaktuara në atë dokument me vetë faktin e ratifikimit të Marrëveshjes së Brukselit, bazat e së cilës bazohen në të vërtetë në modelet e ofruara të zgjidhjes së sistemit të brendshëm ligjor dhe administrativ në Kosovë. Ndryshe nga skena e paqëndrueshme politike në Kosovë, në periudhën pas vitit 2012, për shkak të koalicioneve relativisht të qëndrueshme qeverisëse, Serbia tregoi një pozicion të qëndrueshëm gjatë bisedimeve, por pa udhëzime të përcaktuara qartë dhe zyrtarisht në kuptim të drejtimit në të cilin duhet

të çojë dialogu. Përveç parimeve të përgjithshme të përcaktuara në *Platformë politike për bisedime përfaqësuesit e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Prishtinë*, një pamje më konkrete e qëllimit dhe skenari i mundshëm i finalizimit të procesit të normalizimit nuk është specifikuar.

Në anën tjetër, sondazhet e opinionit publik kanë treguar se ekziston një nivel i caktuar, por i kufizuar, i besimit mes popullsisë së Kosovës ndaj procesit të dialogut, por edhe ndaj palëve negociuese dhe ndërmjetësuesve. Kështu, një studim i kryer gjatë vitit 2019 në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës zbuloi se BE-ja ende perceptohet si një ndërmjetësues kryesor në procesin e normalizimit të marrëdhënieve. Pak më shumë se 20 e të anketuarve besojnë se BE e ka humbur këtë rol, ndërsa rreth 80% ende presin që BE të angazhohet në të njëjtin kapacitet.³¹ Sidoqoftë, i njëjti studim tregoi se serbët nga Kosova duhet për politikën e jashtme dhe lobim të mbështeten kryesisht në Rusinë (45%) dhe Shtetet e Bashkuara (5.6%), ndërsa BE fitoi besimin e ndërmjetësit në procesin e dialogut prej 8.3%.³² Nga ana tjetër, një sondazh i opinionit publik i kryer midis pjesëtarëve të komunitetit shqiptar shumicë në Kosovës tregon se më shumë se gjysma e qytetarëve nuk shohin një përmirësim në marrëdhëniet midis palëve negociuese dhe nuk besojnë se dialogu i Brukselit ka arritur të normalizojë marrëdhëniet e tyre.³³

Sukseset dhe pengesat në rrugën e normalizimit

Paqartësia konstruktive, si thelbi i përmbajtjes së marrëveshjeve të nënshkuara që nga fillimi i dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, fillimisht parandaluan zbatimin adekuat të tyre. Së bashku me mungesën e theksuar të vullnetit politik të Beogradit dhe Prishtinës për të zbatuar mar-

rëveshjen, paqartësia konstruktive u ofroi një dlibi të mjaftueshme palëve negociuese për të arritur një përparim shumë modest në procesin e normalizimit të marrëdhënieve të ndërsjella. Interpretimet e ndryshme të përmbajtjes së marrëveshjeve e vonuan zbatimin e tyre në një masë të tillë që marrëveshje të caktuara mbetën plotësisht të pazbatuara. Shembulli më i dukshëm i një qasjeje të tillë është detyrimi për të formuar një Asociacion të Komunave me shumicë serbe, ku përveç mosmarrëveshjeve rreth emërimit të këtij organi, kishte pikëpamje të ndryshme për pikat e mbetura të Marrëveshjes së nënshkruar të Brukselit.

Megjithëse marrëveshja parashikonte rregullimin e problemeve në fushat që kanë krijuar probleme për popullsinë në Kosovë për vite me radhë, shumë pak përparim është arritur në lehtësimin dhe thjeshtimin e procedurave dhe masave të rëndësishme për jetën e përditshme të qytetarëve. Progresi drejt lehtësimit të lirisë së lëvizjes ka kontribuar në një masë të kufizuar në rritjen e qarkullimit brenda Kosovës, si dhe për/nga Serbia, ndërsa Marrëveshja për telekomunikacion ka rregulluar pjesërisht funksionimin e rrjetit MTS doo në një pjesë të territorit të Kosovës. Përveç kësaj, integrimi i forcave të sigurisë dhe sistemit gjyqësor ka vendosur në një farë mase sundimin e ligjit në veri të Kosovës, gjë që nuk ishte rasti para nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit. Sidoqoftë, këto suksese janë kryesisht të kufizuara në fushën e veprimtimit, ku proceset e zbatimit janë kryer në mënyrë joadekuate dhe pa një qasje gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e plotë të problemit, përkatësisht në frymën e përgjegjësisë që del nga marrëveshja. Nga shembulli i marrëveshjeve të zbatuara pjesërisht (me sukses), mund të shihet parimi sipas të cilit funksionoi dinamika e procesit të bisedimeve:

- *liria e lëvizjes*: Lëshimi i dokumenteve personale dhe dokumenteve të udhëtimit në Kosovë mbetet një problem serioz për qytetarët e Kosovës me kombësi serbe, ndërsa pronarët e targave që tregojnë qytete në Kosovë³⁴ (lëshuar nga MPB e Serbisë) kanë të kufizuar lirinë e tyre të lëvizjes në territorin e Kosovës (përveç në territoret e katër komunave veriore);

31 NVO AKTIV, Trend analiza, 2019, e qasshme në: <http://ngoaktiv.org/uploads/files/Analiza%20trendova%202019.pdf>
32 Ibid.

33 Kosova Democratic Institute, Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë – Serbi, këndvështrimi i qytetarëve, 2018, qasshëm në: <http://www.votaimo.org/Public/Article?PollDialog=true&PollDialog=false&SelectedTab=Polls&PollSelectedMonthID=&PollSelectedYear=#polls>

34 PR - Prishtinë, KM - Mitrovicë, GL - Gjilan, UR - Ferizaj, PZ - Prizren, GJA (DA) - Gjakova dhe PE - Pejë

- *komunikimi*: shtrirja e sinjaleve të telefonisë mobile të kompanisë MTS doo është e kufizuar në një numër zonash të banuara nga serbët e Kosovës dhe është e pamundur të vendoset një lidhje telefonike/qasje në internet jashtë këtyre zonave;
- *integrimi i forcave të sigurisë*: puna e Policisë së Kosovës në veri shpesh është kritikuar për mungesë të cilësisë dhe ushtrimit adekuat të kompetencave, ndërsa integrimi i ish-anëtarëve të Mbrojtjes Civile ende nuk ka përfunduar plotësisht;
- *integrimi i gjyqësorit*: Puna e institucioneve gjyqësore të integruara përballet me një numër problemesh, duke filluar me mungesën e stafit, mungesën e përkthimit (të saktë dhe në kohë) (për gjuhën shqipe dhe serbe) dhe lëndët e akumuluar.

Njohja e ndërsjellë e certifikatave ADR dhe policave të sigurimit ka thjeshtuar trafikun dhe qarkullimin e mallrave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por në dritën e problemeve të mësipërme, sukcesi në zgjidhjen e barrierave në vendkalime ka mbetur në plan të dytë. Edhe pse serbët e Kosovës nuk përfutuan drejtpërdrejtë nga *Marrëveshja për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal*, procesi i zbatimit të marrëveshjes, me kufizime të konsiderueshme, megjithatë prodhoi një rezultat pozitiv. Një epilog i ngjashëm ndodhi me shkëmbimin e zyrtarëve ndërlidhës, i cili funksionoi deri në një periudhë të caktuar kohore, por pas përfundimit të mandatit të zyrtarëve në Beograd, ai proces ngeci. Së fundmi, integrimi administrativ i katër komunave veriore mund të tregohet si një sukses, si dhe mbajtja me sukses e zgjedhjeve lokale dhe formimi i autoriteteve lokale. Megjithëse i shoqëruar me incidente, cikli i parë zgjedhor i organizuar në bazë të Marrëveshjes së Brukselit ku procedurat themelore demokratike u ndoqën, përmbushi kështu qëllimin e saj.

Ndërsa, zbatimi i marrëveshjeve të tjera hasi në një numër pengesash që parandaluan zbatimin e tyre optimal:

- shkëmbimi i shënimeve kadastrale dhe librave të regjistrimit civil nuk është kompletuar plotësisht dhe i nënshtrohet ndërprerjeve të

shpesh të procesit të sinkronizimit;

- Asociacioni i Komunave Serbe nuk është formuar dhe faza e parë e procesit u ndërpre nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për shkak të antikushtetutshmërisë së pikave të caktuara të Marrëveshjes së Brukselit³⁵;
- nuk ka pasur progres në fushën e energjisë, rivitalizimit të urës së Mitrovicës dhe njohjen reciproke të diplomave.

Përveç proceseve të lidhura drejtpërdrejtë me bisedimet midis Beogradit dhe Prishtinës, ngjarje të caktuara përcaktuan në mënyrë të konsiderueshme dinamikën dhe natyrën e procesit të normalizimit:

- protestat e opozitës në Kosovë kundër formimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe (tetor 2015 dhe janar 2016),
- arrestimi i kryeministrit Ramush Haradinaj në Francë dhe rritja e tensioneve për përpjekjet për hyrjen e trenit me afishe (me ngjyra politike) nga Beogradi në Mitrovicën e Veriut (janar 2017),
- vrasja e politikanit Olliver Ivanoviq (janar 2018),
- futja e taksave për importet e mallrave nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina (nëntor 2018),
- dhe shumë të tjera.

Përveç sa më sipër, një nga faktorët vendimtar që kontribuoi në suksesin e kufizuar të dialogut është mungesa e devijimit nga influenca nacionaliste dhe verbale nxitëse në procesin e dialogut. Këto tendenca shpesh mbështeteshin dhe përforcoheshin nga retorika agresive e përhapur nga media të caktuara, duke rrezikuar kështu marrëdhëniet e brishta ndëretnike. Edhe përkundër përvojës nga pasojat fatale të rolit të medias në trazirat e marsit 2004³⁶, procesi i bisedimeve, i cili duhet të çojë në paqim dhe prosperitet në Kosovë dhe

35 KosSev, Kosovski ustavni sud suspendovao sporazum o Zajednici srpskih opština, 10.11.2015, e qasshme në: <https://kossev.info/kosovski-ustavni-sud-suspendovao-sporazum-o-zajednici-srpskih-opstina/>

36 Organization for Security and Co-operation in Europe, The Representative on Freedom of the Media Miklós Haraszti, Report: The Role of the Media in the March 2004 Events in Kosovo, 2004, e qasshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/6/8/30265.pdf>

rajon për të gjithë qytetarët e saj, megjithatë është i paaftë për të arritur pikun e tij. Pavarësisht nga fakti që dialogu është alternativa më e mirë për konfliktet e dhunshme dhe fërkimet, nga sabotimi i tij nuk mund të përfitojnë palët kundërshtarë.

Qëllimi dhe metodologjia e hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit që përbën bazën e këtij studimi është të përcaktojë qëndrimet, perceptimet dhe interesat autentike të komunitetit serb të Kosovës në procesin e dialogut midis Prishtinës dhe Beogradit. Kjo nënkupton një rishikim të pasojave të shkaktuara nga vendimet e identifikuar gjatë procesit të bisedimeve dhe të zbatuara në praktikë, por edhe qëndrimin ndaj vazhdimit dhe të ardhmes së dialogut nga perspektiva e serbëve të Kosovës.

Pikërisht ky komunitet është prekur drejtpërdrejt në procesin e zbatimit të vendimeve të marra brenda formatit negociues të Brukselit. Duke qenë se u gjet mes Prishtinës dhe Beogradit, pa përfaqësues politikë për të përfaqësuar interesat e tij autentike, këtij komuniteti nuk iu ofrua të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe proaktive në procesin e krijimit të strategjive biseduese dhe vendimmarrjes. Për shkak të mungesës së reagimeve në lidhje me vetë procesin e dialogut, pra perceptimeve dhe qëndrimeve rreth implikimeve që kishte për këtë komunitet, në fokus të këtij studimi ishin pikërisht serbët e Kosovës. Përveç qytetarëve serbë, në përgatitjen e studimit dhe hulumtimit gjithashtu morën pjesë analistë politikë, përfaqësues të sektorit joqeveritar dhe mediat në Kosovë.

Para fillimit të procesit të mbledhjes së të dhënave nga terreni, një ekip i zgjedhur me katër anëtarë (hulumtuesi kryesor, këshilltari ligjor, këshilltari politik, redaktori) në dritën e sukseseve dhe implikimeve për komunitetin serb të Kosovës zhvilloi një studim bazë mbi aspektet ligjore, politike dhe socio-ekonomike të dialogut. Partnerët që morën pjesë në hulumtim organizuan gjithsej tetë grupe të fokusit. Si pjesë e procesit të mbledhjes së të dhënave, OJQ AKTIV organizoi katër grupe të fokusit në veri të Kosovës,

ndërsa FDMC ishte përgjegjëse për organizimin e katër grupeve të tjera të fokusit në vendbanimet me shumicë serbe në jug të lumit Ibër. Për të mbledhur informacion të thelluar, u zhvilluan dymbëdhjetë intervista me akterët kryesorë nga komuniteti serb i Kosovës, të cilët posedojnë ekspertizë dhe njohuri në lidhje me procesin e dialogut, si dhe fushat e lidhura ngushtë me temën e këtij hulumtimi.

Në fund, është e rëndësishme të theksohet se perceptimet dhe qëndrimet e serbëve të Kosovës rreth procesit të dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës nxirren vetëm në bazë të aktiviteteve kërkimore. Gjatë hulumtimit, serbët e Kosovës u inkurajuan të flasin lirshëm për pasojat e procesit të dialogut/normalizimit, duke iu dhënë hapësirë për sugjerime dhe propozime për modifikimin ose ndryshimin e plotë të tij.

Metodologjia dhe modeli i hulumtimit sasior

Anketimi ballë për ballë në terren u krye në periudhën nga 1 deri më 20 tetor 2020. Gjithsej 582 qytetarë serb u anketuan në të gjithë Kosovën. 50.5% e të anketuarve janë anketuar në jug të lumit Ibër, ndërsa 49.5% e të anketuarve janë anketuar në veri të lumit Ibër. Pyetësori përbëhej nga 65 pyetje dhe përfshinte gjithsej 8 fusha. Mostra ishte e qëllimshme, me kuotë, dhe kriteri për përcaktimin e kuotave ishte madhësia e komunës. Intervali i besimit është +/- 5. Në mostër, kishte gjithsej 54.7% meshkuj dhe 45.3% femra. Moshë mesatare e të anketuarve është 44 vjeç. Me arsim fillor ishin 14.4% të të anketuarve, 62.1% me arsim të mesme dhe 23.5% me arsimin të lartë, pra fakultet. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 25.9% janë të punësuar në sektorin publik, 22.3% në sektorin privat, 35.2% janë të papunë, ndërsa 16.6% janë në pension. Është e rëndësishme të theksohet se duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare mbi strukturën demografike të popullsisë së synuar, pra të popullsisë serbe në Kosovë, vetëm kushtimisht mund të flasim për përfaqësim të mostrës

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor

GRUPET E FOKUSIT

Periudha:

Hulumtimi u realizua në periudhën nga 1.9.2020 deri më 28.11.2020.

Instrumenti i hulumtimit:

Një udhëzues bisede me 13 pyetje

Numri i grupeve të fokusit:

8 grupe të fokusit

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve:

80 pjesëmarrës (nga 10 pjesëmarrës në secilin fokus grup)

Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve:

vendbanimi, niveli arsimor, gjinia, mosha dhe profesioni

PERIUDHA:

Periudha:

Hulumtimi u realizua në periudhën nga 1.9.2020 deri më 20.11.2020.

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzues për intervistë me 10 pyetje

Numri i përgjithshëm i të intervistuarve:

12 të intervistuar

Kriteret për zgjedhjen e bashkëbiseduesve:

vendbanimi, profesioni, fusha e interesit/aktiviteteve

Bashkëbiseduesit:

anonim

Dialogu nga perspektiva e serbëve të Kosovës: perceptimet dhe trendet

Me qëllim të mbledhjes së informacionit gjithëpërfshirës mbi perceptimet dhe pikëpamjet e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës mbi procesin e normalizimit të marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, rezultatet e hulumtimit u

paraqiten nga dy perspektiva kohore (e tashmja dhe e ardhmja) dhe dy këndvështrime (eksperte dhe laike). Paragrafët në vijim do të paraqesin rezultatet e hulumtimeve të kryera me metoda cilësore dhe sasore, dhe të ndara në fusha kryesore të hartëzuara gjatë aktiviteteve kërkimore. Fushat tematike të zgjedhura janë rezultat i abstragimit të temave kyçe të identifikuara gjatë hulumtimit, të formuara nga sasia dhe cilësia e informacionit të ndarë nga të anketuarit.

Rishikimi i rrjedhës aktuale të dialogut të Brukselit: banorët dhe ekspertët

Informimi dhe transparencja

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit dhe ekspertët theksuan se, për aq sa kanë mundësi, ndjekin rregullisht lajmet në lidhje me dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës, duke marrë parasysh faktin se të gjitha vendimet e marra prekin drejtpërdrejt serbët e Kosovës. Ky fakt u konfirmua gjithashtu gjatë një anketimi të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës, në jug dhe në veri të lumit Ibër (shih Grafikon nr. 1). Sidoqoftë, siç u theksua në disa raste, informacioni mbi rrjedhën, temat dhe rezultatet e dialogut ishte kryesisht i pakët dhe i përgjithshëm, gjë që është pasojë e mos transparencës së procesit dhe mungesës

së dëshirës së negociatorëve kryesorë për të shpjeguar thelbin e çështjeve të rëna dakord. Për


Deshtëm apo nuk deshtëm, ne këtu u referohemi temave dhe pasojave të dialogut.

pjesëmarrës i grupit të fokusit

raportimin për implikimet e zbatimit të marrëveshjeve në terren. Në një hapësirë të tillë mediatike, është jashtëzakonisht e vështirë të gjesh lajme reale, domethënë objektive, që trajtojnë temën e dialogut.

më tepër, për shkak të mosnjohjes së gjuhës shqipe, serbët në Kosovë u referohen ekskluzivisht mediave që botojnë lajme mbi dialogun në gjuhën serbe, kryesisht në Beograd, gjë që rezultojn në një keqkuptim të shpeshtë të kontekstit lokal në

Grafiku 1. Informimi i qytetarëve për dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës



Shumica e pjesëmarrësve të fokus grupeve theksuan se ata ishin në dijeni për fillimin e bisedimeve dhe përfaqësuesit e Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel. Bashkëbiseduesit theksuan se nuk kanë informacion mbi numrin e saktë të marrëveshjeve të nënshkuara, por se janë në dijeni me përmbajtjen e marrëveshjeve të caktuara. Një numër i vogël i pjesëmarrësve than se numri i përafërt i marrëveshjeve të nënshkuara në Bruksel është afër 30. Për të tjetër është e njohur Marrëveshja e Brukselit nga viti 2013, si një nga dokumentet kryesore, për të cilin ata besojnë se paracaktoi integritimin e komunave veriore në sistemin e Kosovës. Informacioni në lidhje me dialogun merret kryesisht nga mediat në Beograd, të cilat i ndjekin rregullisht, por që i konsiderojnë si të pamjaftueshme për të u njohur me kontekstin lokal dhe shpesh nuk e shohin domosdoshmërinë/nevojën për t'u konsultuar me popullsinë lokale në procesin e mbledhjes së informacionit dhe raportimit nga terreni.

Konsensusi absolut në mesin e të anketuarve lidhur me pozicionin e përgjithshëm mbi dialogun është se ai është në thelb jo-transparent, dhe se ishte i mbingarkuar me trazira politike dhe konflikte verbale midis përfaqësuesve të Beogradit dhe Prishtinës. Në një atmosferë të politizimit të plotë të bisedimeve, informacioni objektiv në lidhje me përmbajtjen dhe përparimin e dialogut ishte lënë në hije, gjë që thelloi gjithashtu hendekun midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve, të cilët u bënë marrës të informacionit ekskluzivisht të ngjyrosur politikisht dhe jo objektiv. Një numër i vogël i të anketuarve shohin arsyen e mos-transparentcës për faktin se zgjidhja e statusit të Kosovës është shumë e ndërlikuar për popullsinë e Kosovës dhe Serbisë, gjë që çoi në një ngërç në bisedime. Sipas fjalëve të njërit prej pjesëmarrësve në grupin e fokusit: "Serbia nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës, prandaj pikërisht kjo është arsyeja pse Beogradi (me qëllim të mirë) u përpoq të fshehtë pjesërisht tema më pak të rënda nga publiku në Serbi."

Në bisedën me qytetarët, përveç jo transparentcës dhe informacionit të kufizuar në lidhje me dialogun, mungesa e interesit të qytetarëve për të informuar rreth dialogut, procesit dhe rrjedhës së

tij, u vu re si një tendencë mjaft e pranishme. Siç u tha, disa shtresa të shoqërisë nuk janë plotësisht të njoftuara me dialogun, përveç nëse kjo është për shkak të natyrës së punës që ata bëjnë. "Njerëzit nuk janë të informuar për atë që diskutohet në tryezën e bisedimeve", dhe bazuar në informacionin që është në dispozicion, "nuk mund të zbulojmë plotësisht kush, çfarë dhe për çka po bisedohet". Hulumtimi ka treguar se gjeneratat e reja nuk janë aspak të njoftuara me procesin e dialogut. Ajo që të gjithë e dinë është se një dialog po zhvillohet në Bruksel, por jo se çfarë do të thotë ai dialog dhe cilat janë qëllimet e tij, dhe kjo e fundit është në të vërtetë burimi kryesor i mungesës së interesit të të rinjve rreth temës së dialogut. Në mbështetje të qëndrimit të përhapur të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës për mungesë të transparencës dhe mungesë të informacionit objektiv dhe të plotë flasin edhe rezultatet e anketës, që tregojnë se 67% e të anketuarve pajtohen me deklaratën se dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës është jo-transparent, dhe se si pasojë ky komunitet nuk ka informacionin e duhur rreth asaj që u dakordua në Bruksel. Kështu, përkundër faktit se ka një interesim në mesin e popullsisë për të informuar në lidhje me dialogun, informatat kthyesë që marrin nga mediat nuk iu ofrojnë njohuri të mjaftueshme për tërë procesin.

Integritimi

Hulumtimi tregoi se ekziston një besim unanim midis serbëve të Kosovës që dialogu nuk e ka përshpejtuar procesin e integritimit të serbëve në shoqërinë kosovare. Të anketuarit ndanë shqetësimin e tyre me faktin se një shoqëri e tillë, siç u theksua, aktualisht nuk ekziston, sepse nga këndvështrimi i komunitetit serb, ajo është ekskluzivisht mono-etnike dhe jo përfshirëse. I gjithë procesi i zbatimit të marrëveshjes i la serbët pa zgjedhje, sepse dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës kontribuoi vetëm në integritimin institucional në sistemin kosovar. Në dritën e kësaj, të anketuarit theksuan se parakushtet zyrtare ligjore për pjesëmarrjen në përfaqësimin politik dhe vendimmarrjen demokratike (në nivelin lokal dhe qendror) për komunitetet jo-shumicë ishin respektuar, por që ky ndryshim



Dialogu nuk e ka përshpejtuar integrimin. Meqenëse integrimi nuk është vetëm zyrtar dhe politik, ai duhet të jetë thelbësor dhe nuk ekziston. Shoqëria kosovare nuk e dëshiron pjesën e saj serbe, e cila është pjesë thelbësore, integrale e asaj shoqërie, dhe vazhdimisht pritet dhe refuzohet rrënjësisht.

politikolog nga një prej komunave në jug të lumit
Ibër me shumicë serbe

përmes dialogut midis palëve negociuese në thelb nuk e mbështeste procesin e integrit të serbëve në shoqërinë kosovare. Konfirmimi i qëndrimeve të tilla të përhapura mund të gjendet gjithashtu në rezultatet e anketimit që tregojnë se **62.8%** e të anketuarve besojnë se dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit u ka sjellë më shumë të mira shqiptarëve sesa serbëve në Kosovë dhe se i njëjti qëndrim prej **66.5%** e të anketuarve ndahet edhe nga ata me arsim të lartë.

Hulumtimi tregoi se ekziston një besim unanim midis serbëve të Kosovës që dialogu nuk e ka përshpejtuar procesin e integrit të serbëve në shoqërinë kosovare. Të anketuarit ndanë shqetësimin e tyre me faktin se një shoqëri e tillë, siç u theksua, aktualisht nuk ekziston, sepse nga këndvështrimi i komunitetit serb, ajo është ekskluzivisht mono-etnike dhe jo përfshirëse. I gjithë procesi i zbatimit të marrëveshjes i la serbët pa zgjedhje, sepse dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës kontribuoi vetëm në integrimin institucional në sistemin kosovar. Në dritën e kësaj, të anketuarit theksuan se parakushtet zyrtare ligjore për pjesëmarrjen në përfaqësimin politik dhe vendimmarrjen demokratike (në nivelin lokal dhe qendror) për komunitetet jo-shumicë ishin respektuar, por që ky ndryshim përmes dialogut midis palëve negociuese në thelb nuk e mbështeste procesin e integrit të serbëve në shoqërinë kosovare. Konfirmimi i qëndrimeve të tilla të përhapura mund të gjendet gjithashtu në rezultatet e anketimit që tregojnë se **62.8%** e të an-



Disa nga marrëveshjet e nënshkuara kanë bërë që serbët të përfshihen më shumë në sistemin kosovar. Për shembull, marrëveshja për gjyqësorin. Edhe në atë situatë, nuk bëhet fjalë për ndonjë integrim real, por për përshtatje, si me marrëveshjet e tjera, sepse zakonisht njerëzit nuk pyeten nëse duan diçka, por së pari arrihet një marrëveshje, dhe pastaj njerëzit i përshtaten asaj marrëveshje. Pra, në sistemin kosovar, nuk ka asnjë përfshirje thelbësore të serbëve, por bëhet fjalë vetëm për pjesëmarrje.

jurist

ketuarve besojnë se dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit u ka sjellë më shumë të mira shqiptarëve sesa serbëve në Kosovë dhe se i njëjti qëndrim prej **66.5%** e të anketuarve ndahet edhe nga ata me arsim të lartë.

Ekspertët në fushën e ligjit të cilët u intervistuan gjatë hulumtimit theksuan se bisedimet midis Prishtinës dhe Beogradit ndihmuan ndjeshëm integrimin e serbëve kur bëhet fjalë për integrimin e gjyqësorit. Procesi i integrit të gjyqësorit ka çuar në një përmirësim të punës së gjykatave dhe kështu ka përshpejtuar zgjidhjen e lëndëve që, për shkak të ekzistencës të sistemeve paralele, nuk janë zgjidhur. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit u pajtuan me këtë qëndrim, shpesh duke shtuar se dialogu ka ndikuar në integrimin vetëm kur bëhet fjalë për këtë fushë dhe se vetë procesi ka shumë mangësi.

Në anën tjetër, një nga faktorët kryesorë në mungesën e integrit të serbëve në sistemin kosovar është pozicioni jo konsistent dhe në disa vende i dyfishtë i përfaqësuesve të institucioneve të nivelit qendror, posaçërisht të Qeverisë së Kosovës. Përkundër faktit se përfaqësuesit e Qeverisë vazhdimisht theksojnë rëndësinë e integrit të këtij komuniteti në sistemin kosovar, të anketuarit ende

nuk e njohin vullnetin dhe angazhimin e vërtetë të së njëjtës Qeveri që procesi i integritit të ndodhë në të vërtetë. Siç është theksuar shpesh, ekziston një keqkuptim midis zyrtarëve të qeverisë qendrore se integrimi i një komuniteti jo-shumicë është i suksesshëm nëse pjesëtarët e tij janë pjesë të institucioneve (të Kosovës) dhe pjesë e punës. Procesin e integritit të një komuniteti në një sistem të caktuar është një "proces kompleks dhe kërkon shumë kohë që kërkon sakrificë dhe përshtatje ekstreme", parë nga perspektiva e serbëve të Kosovës. Pikërisht për këtë arsye, gjatë aktiviteteve kërkimore, ekzistonte një mendim midis të anketuarve se procesi i normalizimit të marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit, si i tillë, është vetëm një prej faktorëve që kishin një ndikim të drejtpërdrejtë në integrim. Në këtë drejtim, hulumtimi ka treguar se dialogu nuk njihet si një faktor kryesor në përfshirjen e komunitetit serb të Kosovës në sistemin ligjor dhe administrativ të Kosovës. Për më tepër, siç kanë treguar sondazhet e opinionit publik, pikëpamjet e polarizuara për ndikimin e dialogut në fushën e të drejtave në dispozicion të pjesëtarëve të këtij komuniteti tregojnë se procesi i integritit është ende në vazhdim dhe se nuk është i qartë.




Serbët ishin dhe janë margjina sociale dhe socio-ekonomike në Kosovë.

gazetar

Ndikimi i marrëveshjes në jetën e zakonshme të qytetarëve dhe të komunitetit

Shumica e të anketuarve ia atribuuan dialogut të Brukselit ndikimin negativ në komunitetin serb në Kosovë, sepse, nga njëra anë, ishin vazhdimisht në fokusin mediatik dhe politik, ndërsa, nga ana tjetër, shumë pak ishte implementuar. U theksua se bisedimet negativisht "mendërisht, dhe jo vetëm fizikisht, ndikuan në gjendjen e komunitetit serb në Kosovë", pavarësisht nëse bëhet fjalë për një zonë në jug apo në veri të lumit Ibër. Duke shpjeguar dhe arsyetuar individualisht dhe kolektivisht karakterizimin negativ të ndikimit të dialogut, të anketuarit ndanë një numër përvojash personale negative që hasën duke filluar nga periudha e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit:

Grafiku 2. Ndikimi i marrëveshjes në jetën e zakonshme të qytetarëve dhe të komunitetit



Telekomunikacioni. U zbulua se ka probleme të shpeshta me qasjen në rrjetin mts doo në veri të Kosovës, ndërsa situata në jug të lbrit është më drastike për shkak të shtrirjes së kufizuar të rrjetit ("është e turpshme dhe diskriminuese që shtrirja e stacioneve bazë të rrjetit në jug të lumit Ibër është aq e kufizuar", siç e tha një pjesëmarrëse e grupit të fokusit), ndërsa, siç thuhet, kostoja e shërbimeve mts doo është më e madhe krahasuar me mts në Serbi. Pikërisht për shkak të kostove shtesë dhe kufizimeve të papërfillshme të përdorimit të shërbimeve mts doo, të anketuarit gjejnë prova thelbësore se marrëveshja (për telekomunikacionin) nuk e zgjidhi problemin por vetëm e thelloi atë.

Liria e lëvizjes. Siç thuhet shpesh, shumica e popullsisë në një farë mënyre tashmë është përshtatur me situatën e krijuar nga zbatimi i marrëveshjes (për lirinë e lëvizjes). Shumica e të anketuarve kanë më shumë se një lloj dokumentesh dhe, siç u theksua, "sipas natyrës, gjërat i përshtaten situatës", sepse "është bërë tashmë një zakon në të cilin jetojnë çdo ditë". Sidoqoftë, përshtatshmëria nuk zgjidh diskriminimin nga i cili vuajnë serbët e Kosovës, siç u theksua në fokus grupe, për shkak të situatës në të cilën ata gjenden padashje, dhe kështu janë njësoj viktimë të diskriminimit nga institucionet e Kosovës dhe Serbisë, si për shkak të dokumenteve ashtu edhe në vendkalime. Përkundrazi, avokati nga komuna e Graçanicës, duke folur për mungesën e ndikimit të drejtpërdrejtë të dialogut për ndryshimin e mënyrës së jetës së të gjithë komunitetit serb në Kosovë, theksoi se lehtësimi i vetëm për popullsinë serbe në Kosovë është njohja reciproke e dokumenteve. Siç theksoi ai, kjo lëvizje ishte me rëndësi të madhe për shtetasit e Kosovës, të cilët duhet të udhëtojnë shpesh dhe janë të lidhur me Serbinë.

Integrimi i gjyqësorit dhe policisë në veri. Siç theksojnë bashkëbiseduesit nga veriu i Kosovës, integrimi i gjyqësorit vetëm ka përkeqësuar situatën e përgjithshme. Duke përmbledhur këtë pozicion të përhapur, një nga pjesëmarrësit e grupeve të fokusit përshkroi pakënaqësinë me zbatimin e marrëveshjes si më poshtë: "Shkresurinat janë katastrofike, përkthimet e këqija dhe joadekuate



Liria e lëvizjes është e iluzore, nuk është realiste. Liria e lëvizjes është rritur, por edhe kostot e lëvizjes janë rritur. Askush përveç nesh, të shtyer nga rrethanat, nuk duhet të zgjedhë midis tre llojeve të dokumenteve.

pjesëmarrëse e grupit e fokusit

në serbisht janë të shpeshta, ndërsa marrja e certifikatave është edhe më e komplikuar." Sipas qëndrimeve të serbëve në jug dhe në veri të lumit Ibër, përfitimi i vetëm i integritit u ndie nga ata që u punësuan, d.m.th. u integruan në sistemin e ri. Për më tepër, problemi është se sistemet gjyqësore të Kosovës dhe Serbisë nuk kanë kanale të komunikimit zyrtar, dhe kështu qytetarët e zakonshëm bëhen viktimë të konfliktit të autoritetit dhe mungesës së bashkëpunimit midis organeve gjyqësore. Nga ana tjetër, ekziston një farë shkalle besimi në policinë e integruar të Kosovës në veri dhe në jug, por vetëm dhe ekskluzivisht për faktin se në zonat me shumicë serbe, "një numër i konsiderueshëm i serbëve të Kosovës janë në mesin e tyre". Kritika ndaj policisë është drejtuar gjatë grupeve të fokusit, kryesisht për shkak të pasivitetit të shpeshtë dhe efektivitetit të dobët, të gjitha në dritën e incidenteve të shpeshta të sigurisë që kanë ndodhur kohët e fundit (gjatë pandemisë së virusit COVID-19) në zonat e populluara nga serbët (jo vetëm në komunat me shumicë serbe).

Arsimi. Nostrifikimi dhe verifikimi i diplomës është një problem i madh për të rinjtë serbë të Kosovës të cilët dëshirojnë të qëndrojnë në Kosovë dhe të punësohen. Procesi administrativ është shumë i komplikuar, siç theksuan të anketuarit më të rinj me arsim të lartë, ("shumë instanca janë të përfshira në të gjithë procesin"). Përveç që ky fakt vepron si një faktor demotivues për të rinjtë, ai, nga ana tjetër, përshpejton edhe më shumë vendimin e të rinjve për t'u larguar nga Kosova dhe për të kërkuar vende me një klimë më të mirë ekonomike dhe sociale.

Perceptimi negativ i ndikimit të procesit të bisedimeve në jetën e serbëve në Kosovë u konfirmua gjithashtu nga rezultatet e anketës, por jo në atë masë që ishte i pranishëm në mesin e të anketuarve në fokus grupe. Edhe pse një numër i konsiderueshëm - **48.8%** i të anketuarve (**35.5%** që pajtohen dhe **13.3%** që pajtohen plotësisht) - u pajtua me qëndrimin se dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës kishte një ndikim negativ në pozitën e serbëve në Kosovë, dhe mendim të kundërt shprehën **24.3%**. Pavendosmëria e të anketuarve prej afër një çereku (**23.5%**) tregon se ka dyshime në mesin e popullatës në lidhje me marrëdhëniet (potenciale) shkak-pasojë midis vendimeve të marra si rezultat i bisedimeve dhe përmirësimit/përkeqësimit të kushteve të jetesës së serbëve të Kosovës. Sidoqoftë, dallimet në mendime për këtë çështje u vunë re midis të anketuarve në veri të Kosovës, ku **42.6%** ranë dakord për karakterizimin negativ të dialogut (një përqindje e lartë prej **32.1%** e pacaktuar), dhe në jug, ku përqindja është dukshëm më e lartë - **54.9%**, me dy herë më pak të papërcaktuar - **15%**. Gjithashtu, është interesante të përmendet se një përqindje e lartë e qëndrimeve negative ndaj dialogut u gjet në mesin e të anketuarve me një situatë të qëndrueshme ekonomike - **55.6%**.

Marrëdhëniet ndëretnike

Një sondazh për opinionin e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës zbuloi se dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit nuk nxiti bashkëpunimin dhe nuk uli tensionet etnike në mes të komunitetit serb dhe shqiptar në Kosovë. Më shumë se gjysma e të anketuarve (**51.6%**) vuri në dukje se dialogu nuk i përmirësoi marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, edhe dy dekada pas përfundimit të luftës. Përafërsisht që një numër i ngjashëm i të anketuarve - ata që janë të pavendosur rreth kësaj çështje (**22.5%**) - dhe të anketuarit që vlerësojnë pozitivisht ndikimin e dialogut në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike (**19.7%**), tregon faktin se ende nuk ka kuptim të qartë në mesin e popullatës në lidhje me lidhjen shkakësore midis procesit të negociatave dhe marrëdhënieve midis komuniteteve.



Qetësimi i tensioneve ndëretnike është i qartë, sepse kemi shumë më pak incidente sesa kur nuk kemi biseduar. Nga ana tjetër, roli i monitorimit ndërkombëtar vendos një lloj përgjegjësie tek shqiptarët që të sillen më me përgjegjësi dhe më të hapur ndaj komuniteteve të tjera, gjë që është pozitive.

aktivistë nga sektori i organizatave joqeveritare

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve të grupeve të fokusit ranë dakord njëzëri se dialogu nuk ndikoi drejtpërdrejt në marrëdhëniet midis komuniteteve serbe dhe shqiptare. Kur bëhet fjalë për pjesëtarët e komunitetit serb që jetojnë në veri (përveç në rastin e Mitrovicës së Veriut), ky qëndrim pjesërisht buron nga fakti se komuniteti shqiptar nuk është i shumtë në komunat veriore. Në rastin e Mitrovicës së Veriut, si një nga mjediset e pakta multietnike në Kosovë, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit si dhe ekspertët e intervistuar theksuan se marrëdhëniet janë relativisht të mira dhe se në atë kuptim dialogu nuk kishte aspak efekt në përmirësimin e pjesshëm të marrëdhënieve midis komuniteteve. Sa i përket tërë Kosovës, bashkëbiseduesit janë unanimë në përfundimin se dialogu as nuk e ka penguar dhe as nuk ka kontribuar në procesin e pajtimit, sepse, sipas mendimit të tyre, ai proces në të vërtetë as nuk ka filluar. Ajo që u vu re nga të anketuarit është se një ndikim i rëndësishëm i dialogut në segmentin e komunikimit institucional me Prishtinën është potencuar, që në periudhën para nënshkrimit dhe implementimit të marrëveshjes nuk ishte me intensitet të lartë. Bashkëpunimi midis pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme brenda institucioneve ka krijuar kanale të reja të komunikimit, por ato jo domosdoshmërisht kanë kontribuar në përmirësimin e përgjithshëm të marrëdhënieve ndëretnike.

Perceptimet në lidhje me këtë çështje midis serbëve në jug dhe veri të lumit Ibër ndryshojnë në nuanca, duke marrë parasysh faktin që pjesëtarët e komu-

nitetit në jug janë në kontakt më të shpeshtë me pjesëtarët e shumicës dhe komunitetet e tjera. Sidoqoftë, ata ndajnë mendimin se nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me ndryshimin në natyrën ose dinamikën e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve në Kosovë. Gjithashtu, qëndrimet në lidhje me procesin e pajtimit dhe ndikimin e dialogut në të provuan të jenë uniforme në kuptimin që ende nuk ka pajtim thelbësor dhe se mungesa e vullnetit politik është një nga pengesat kryesore në atë drejtim.


Palët negociuese dhe ndërmjetësuesit

Duke përjashtuar Beogradin, bashkëbiseduesit identifikuan subjektet e tjera negociuese si faktorë përcarës në arritjen e një jete të qëndrueshme, stabile dhe të sigurt për serbët në të gjithë Kosovën. Pavarësisht nga mungesa e një qasje konsultative të Beogradit dhe moskuptimit të shpeshtë të kontekstit lokal (specifik), pjesëmarrësit unanimitisht e shënuan këtë subjekt si të vetmin që mbron interesat e këtij komuniteti në Kosovë, por edhe në skenën ndërkom-bëtare. Gjatë bisedës rreth subjekteve negociuese, u përmend narrativi për shkëmbimin e mundshëm të territoreve, i cili ishte pjesë e diskursit të dialogut për një periudhë të caktuar kohore; pjesëmarrësit theksuan se fshehtësia e mbuluar rreth gjendjes specifike të një zgjidhjeje të tillë përhapte trazira midis pjesëtarëve të komunitetit serb në jug të Ibrit,

por edhe midis atyre në veri, pasi nuk ishte e qartë se cila vijë ndarëse do të përdorej për të ashtuquajturin demarkacion. Kështu, të paktën për një periudhë të caktuar kohe, besimi te Beogradi u lëkund pjesërisht.

Në të kundërt, disa të anketuar shprehën mosbesim në mënyrën se si Beogradi përfaqësonte interesat e komunitetit serb të Kosovës gjatë bisedimeve në Bruksel. Rezultatet e sondazhit të opinionit publik treguan se më shumë se gjysma (**54.8%**) e serbëve vlerësuan negativisht punën e ekipit negociator Serb në përpjekjet e tyre për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat autentike të këtij komuniteti jo-shumicë. Të anketuarit në veri të Kosovës (**63%**) në krahasim me bashkëqytetarët e tyre që jetojnë në jug të lumit Ibër (**46.7%**) vlerësuan përfaqësimin e interesave të serbëve të Kosovës nga Beogradi me një dozë më të madhe kritikash. Një ndryshim në mbështetje është vërejtur midis qëndrimeve që ndryshojnë në bazë territoriale, për faktin se **36%** e të anketuarve në jug vlerësuan pozitivisht aktivitetet përfaqësuese të Beogradit, ndërsa në veri numri është disi më i ulët - **22.3%**. Gjatë sondazhit, u vërtetua gjithashtu se **70.1%** e të anketuarve të punësuar në sektorin privat vlerësojnë negativisht angazhimin e Beogradit në përfaqësimin e interesave të serbëve të Kosovës, ndërsa në spektrin e kundërt, pra me qëndrim të kundërt, janë qytetarët mbi 66 vjeç - **52%**.

Grafiku 3. Në dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës, ekipi negociator i Serbisë nuk përfaqësoi siç duhet interesat e serbëve nga Kosova



Të anketuarit theksuan se ndërmjetësimi i Bashkimit Evropian gjatë bisedimeve nuk ndikoi aspak në qëndrimin e serbëve të Kosovës ndaj komuniteteve dhe institucioneve të tjera. BE është etiketuar si një entitet i pjekur mjaftueshëm për një "marrëveshje të madhe si çështja e zgjidhjes së problemit të Kosovës", dhe nga këtu rrjedh qëndrimi negativ i përhapur ndaj dialogut dhe ndërmjetësuesit kryesor. Pavarësisht nga subjekti që do të kishte rolin e ndërmjetësuesit në dialog, pjesëmarrësit besojnë se nuk do të ketë progres domethënës në drejtim të përmirësimit të marrëdhënieve midis serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. E njëjta gjë do të ishte rasti me qëndrimin e serbëve ndaj institucioneve të Kosovës, sepse, siç u tha, "dëmi ndaj serbëve në Kosovë është bërë, kështu që ndryshimi i ndërmjetësuesit vetëm se do të përkeqësonte situatën aktuale". Nga ana tjetër, ekspertët deklaruan se palët negociuese nuk kanë "të njëjtin pozicion fillestar" dhe pozicionet e tyre janë në kundërshtim të plotë kur bëhet fjalë për zgjidhjen e problemeve. Kështu, roli i ndërmjetësit është dukshëm i kufizuar. Kjo është arsyeja pse, siç pretendojnë ata, i vetmi sukses i arritur me ndërmjetësimin e Brukselit është përbalja me pengesat e një natyre teknike, të cilat mund të ishin zgjidhur pa ndërhyrë në fusha më tërëqësore dhe me ngjyra politike. Ajo për të cilën BE u kritikua është lejimi i "bisedimeve pas dyerve të mbyllura". Një akt i tillë, siç u tha, paraqet mosrespektim, jo vetëm ndaj komunitetit serb, por edhe ndaj komuniteteve të tjera në Kosovë. Sipas bashkëbiseduesve, ky mosrespektim dhe jo transparencë e tërë procesit është për faj të subjekteve negociuese, të cilat "përfaqësojnë interesa personale, dhe jo të komuniteteve që jetojnë në Kosovë". Për më tepër, ekspertët theksuan se ngritja e dialogut nga një nivel teknik në një nivel më të lartë (politik) ishte një gabim i madh, pikërisht si një konfirmim i tezës së mëparshme të paraqitur në grupet e fokusit. Ndikimi i interesave politikë të negociatorëve kryesorë nga Beogradi dhe Prishtina e pamundësoi potencialin e ndërtuar gjatë bisedimeve të zhvilluara në nivelin teknik.

Duke diskutuar mundësinë që Prishtina të pranojë të përfaqësojë interesat autentike të serbëve të Kosovës (në konsultim me popullsinë lokale) në



Çdo zgjidhje e problemit është rezultat i koncesioneve nga njëra palë ose tjetra, dhe jo një kompromis, siç duhet të jetë.

pjesëmarrëse e grupit e fokusit




Bashkimi Evropian nuk u tregua të jetë një ndërmjetës i mirë në ndërmjetësimin e procesit të dialogut. Arsyen për këtë e shoh në faktin se Bashkimi Evropian nuk ka ndonjë ndikim të madh ndaj ndonjëris prej palëve negociuese.

pjesëmarrës i grupit të fokusit

vazhdimin e dialogut, ekspertët theksuan se kjo palë negociuese nuk ka dëshirë të përmirësojë pozitën e serbëve dhe se, siç theksoi njëri prej tyre, "për atë arsye, në këtë moment, nuk mund të përfaqësojë interesat" e këtij komuniteti. I njëjti bashkëbisedues theksoi se "përfaqësuesit e Beogradit janë tolerant dhe përfaqësuesit e Prishtinës veprojnë me qëndrime maksimaliste të bazuara në impulse nacionaliste", gjë që nuk lë hapësirë për manovër për të arritur konsensus mbi çështjet kryesore. Për më tepër, në një kohë kur ekziston një lloj rivaliteti midis BE-së dhe SHBA-vë mbi përparësinë e ndërmjetësimit në dialog, një njohës i situatës në Kosovë, politikolog nga Beogradi, thekson se "ai [rivaliteti] vetëm rrit konfuzionin në të kuptuarit e procesit dhe transparencën e rezultatit", dhe beson se kjo lloj konkurrence do të ndikojë në besimin në dialog, sepse në mënyrë standarde është në një nivel të ulët, pavarësisht nga gjithçka.

Një sondazh i realizuar midis serbëve të Kosovës gjithashtu flet për qëndrime të ngjashme ndaj besimit në subjektet negociuese dhe ndërmjetësues. Përderisa nivelin më të lartë të besimit e gëzojnë akterët Beogradi me **(63.2%)**, një shkallë e lartë e mosbesimit shprehet ndaj Prishtinës **(88.2%)**, BE-së **(83%)** dhe SHBA-ve **(81.2%)**

Grafiku 4. Sa ju besoni akterëve në vijim të Dialogut të Brukselit?



Asociacioni i komunave serbe

Shumica absolute e bashkëbiseduesve nuk ishin të informuar në detaje rreth konceptit të AKS-së, kështu që nuk është e qartë për ta se çfarë lloj kompetencash do të kishte ky organ. Vetë fakti që AKS ende nuk është formuar është një nga argumentet kryesore të shqyrtuara se dialogu nuk është i suksesshëm. Sidoqoftë, u theksua se në periudhën pas nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e AKS-së, kishte mundësi për një zgjidhje të qëndrueshme institucionale për serbët e Kosovës (si dhe për të përmirësuar potencialisht kushtet e tyre të jetesës në Kosovë), por që vonimi dhe refuzimi i formimit të tij distancoi popullatën lokale nga ideja e AKS si një zgjidhje optimale. Në rast se AKS bëhet përsëri një temë kryesore e bisedimeve, Beogradi duhet të insistojë në mbajtjen e institucioneve të buta të financuara nga Serbia në Kosovë, sepse, siç u theksua, ato janë "garantuesi i mbijetesës së serbëve në Kosovë". Nga ana tjetër, do të ishte jashtëzakonisht e rëndësishme të lihej hapësirë e

mjaftueshme për komunikim të drejtpërdrejtë me institucionet e Kosovës, ku, siç u theksua, "do të përfitonin të dyja palët negociuese".

Si një argument kryesor në favor të formimit të Asociacionit të Komunave Serbe, i cili u theksua gjatë hulumtimit, se një veprim i tillë do t'i siguronte popullatës serbe siguri institucionale dhe mbijetesë të komunitetit serb në Kosovë (dhe kthim të personave të zhvendosur). Sidoqoftë, për shkak të faktit se AKS nuk është formuar, si dhe se ekziston një devijim i qartë i Prishtinës nga detyrimet që rrjedhin marrëveshjet e nënshkruara, shumica e bashkëbiseduesve theksuan se dyshojnë që AKS e formuar (nën presionin e BE) do të mbronte interesat vitale të komunitetit serb, dhe në masë edhe më të vogël do të përmirësonte marrëdhëniet me komunitetin shumicë, dhe të forcojë procesin e integritit dhe komunikimin me institucionet qendrore. Të anketuarit besojnë se një kompromis mbi AKS nuk do të arrihet në të ardhmen e afërt,

si dhe se formimi i këtij organi është praktikisht një "mision i pamundur". Fitohet përshtypja se ekziston një dëshirë e fortë dhe e theksuar për të formuar një institucion të tillë për shkak të mungesës së sigurisë institucionale, sociale, ekonomike dhe kulturore që është në kurriz të serbëve të Kosovës. Disa pjesëmarrës shtuan se është e nevojshme të formohet një numër shtesë i komunave (me shumicë serbe), në mënyrë që të garantohet mbijetesja e serbëve që jetojnë në enklava në jug të lumit Ibër dhe në të njëjtën kohë të përfshihen në AKS. Kështu, gjatë fokus grupeve të mbajtura me banorët lokalë që jetojnë në jug të lumit Ibër, u propozua që të formohen komuna që do të përfshinin vende të banuara kryesisht nga serbë, të tilla si Prilluzha, Plemetini dhe Babimoci.

Një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve të grupeve të fokusit që jetojnë jashtë (ose me origjinë nga) komuna që potencialisht do të bëhen pjesë e Asociacionit të Komunave Serbe shprehën frikën se formimi i asaj njësie administrativo-territoriale do të përjashtonte dhe izolonte më tej serbët e Kosovës që jetojnë jashtë komunave me shumicë serbe. U theksua se banorët e vendeve si Hoça e Madhe, Shillova, Gorazdheci, Plemetini, Prilluzha, Babimoci, Bërnica e Poshtme, Kuzmini dhe Suhogërlla nuk do të ishin të barabartë në raport me bashkëqytetarët e tyre që jetojnë në komuna, anëtare të mundshëm të AKS.

Ekspertët dhe disa pjesëmarrës të grupeve të fokusit shprehën shqetësimin se formimi eventual i AKS-së do të bëhej një mekanizëm për shuarjen e të gjithëve Institucionet serbe në Kosovën. Sipas fjalëve të një prej aktivistëve lokalë që është aktiv në komunat në jug të lumit Ibër: "E shoh AKS si fundin e të gjitha institucioneve që mund të përpqen të përfaqësojnë burimin e mbijetesës së serbëve si një popull në Kosovë. Është një perde e shuarjes së institucioneve të mbetura të Republikës së Serbisë." Kolegu i tij nga veriu thekson se "në letër, AKS-ja vepron si akti përfundimtar i ndarjes së dy popujve", dhe se "nëse marrëveshja për AKS-në zbatohet plotësisht, ajo duhet të përfaqësojë entitetin e tretë vendimmarrës në Kosovë".

E ardhmja e dialogut të Brukselit: dëshirat dhe frika

Tema të reja - mundësi të reja

Siç u theksua në disa raste gjatë hulumtimit, zgjedhja e temave të negociuara në Bruksel nuk u ndikua nga komuniteti serb në Kosovë. Pikërisht për këtë arsye, të gjithë bashkëbiseduesit theksuan se temat e zgjedhura nuk mbuluan në mënyrë thelbësore disa nga problemet kryesore që shqetësojnë serbët në Kosovë. Kjo është arsyeja pse të anketuarve u është ofruar të sugjerojnë tema që palët negociuese potencialisht do të adresojnë, dhe të cilat janë me rëndësi prioritare për komunitetin serb të Kosovës. Përveç një numri temash të propozuara nga pjesëmarrësit e grupeve të fokusit, u theksuan tre tema kryesore dhe fusha që duhet të diskutohen në të ardhmen, të cilat nga ana tjetër do të motivonin serbët e Kosovës për të vendosur besim në institucionet dhe komunitetet e tjera në Kosovë:

- Zgjedhja e çështjes së të zhdukurve dhe të rrëmbyerve (në periudhën 1998-2004) dhe krijimi i kushteve të qëndrueshme për kthimin e qetë dhe të sigurt (të paktën një pjesë) të personave të zhvendosur, me garanci të forta nga bashkësia ndërkombëtare, si faktorë kryesorë në fuqizimin e drejtësisë tranzicionale;
- Përsheptimi i procesimit të marrëdhënies të pazgjdhura juridiko-pronësore private dhe zgjidhjes së çështjeve të uzurpimit të pronave në pronësi të serbëve;
- Krijimi i mbrojtjes së qëndrueshme të trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë përmes një pranie të shtuar të forcave ndërkombëtare të sigurisë dhe krijimit të një mbrojtje efektive ligjore dhe kushtetuese të pasurive të paluajtshme kulturore.

Kur bëhet fjalë për drejtësinë tranzicionale, u theksua se ajo është ende viktimë e "murit ekzistues që ndan komunitetet në Kosovë". Si pasojë, "komunitetet kanë frikë nga njëri-tjetri dhe bashkëpunimi ekziston vetëm kur është i domosdoshëm dhe i pashmangshëm", pikërisht sepse dy dekada kanë humbur pa përparim të dukshëm drejt pajtimit

të qëndrueshëm bazuar në fakte të vërtetuara rreth viktimave të luftës. Një kusht i domosdoshëm në atë rrugë është ndjekja penale e personave përgjegjës (nga radhët e UÇK-së) për krimet e kryera, duke konsideruar, siç theksuan shumica e të anketuarve, mungesën e drejtësisë në favor të viktimave të kombësisë serbe.

Si një nga komponentët kryesor, që, siç thanë të anketuarit, është një parakusht për ndërtimin e marrëdhënieve më të mira midis komuniteteve dhe forcimin e besimit në institucionet (e Kosovës), është tejkalimi i pengesave që ("për një kohë të gjatë") qëndrojnë në rrugën e kthimit të pronës së uzurpuar për pronarët e saj të ligjshëm. Mungesa e vullnetit politik për të adresuar këtë çështje kyçe perceptohet si shkak kryesor i ngërçit të gjatë në progres në fushën e respektimit të një prej të drejtave themelore të njeriut - mbrojtjen dhe paprekshmërinë e pronës private. Sipas ekspertëve të intervistuar, keqpërdorimet e kësaj të drejte janë tregues i paaftësisë së institucioneve të nivelit qendror në Kosovë për të ushtruar kompetencat e tyre statutoare. Për më tepër, fakti që palët e dëmtuara janë pjesëtare të një komuniteti jo-shumicë tregon ekzistencën e diskriminimit institucional ndaj komunitetit serb.

Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare, të cilat janë të lidhura ngushtë me historinë dhe identitetin e serbëve në Kosovë, ka provuar të jetë një nga temat e nxehta me interes për këtë komunitet. Mbrojtja institucionale deklarative e trashëgimisë së Kishës Ortodokse Serbe, siç pretendojnë të anketuarit, është e pamjaftueshme për ruajtjen e tyre dhe përfaqëson një objektiv të prekshëm midis shtresave ekstreme të shoqërisë kosovare. Në këtë kuptim, hulumtimi paraqiti një seri propozimesh praktike që do të siguronin mbrojtje të qëndrueshme të kishave, manastireve dhe ndërtesave me rëndësi të madhe për serbët, duke filluar nga ekterritoriteti i pasurive të patundshme deri te angazhimi i njëjësive shtesë të sigurisë të përbërë nga anëtarë të misioneve ndërkombëtare (siç është KFOR) me qëllim të mbrojtjes së tyre.


Përveç temave të mësipërme të një rëndësie thelbësore për këtë komunitet të propozuara

gjatë hulumtimit, fusha që konsiderohen të jenë me prioritet për vazhdimin e bisedimeve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës së serbëve në Kosovë janë:

- njohja e dokumenteve të lëshuara nga Administrata Koordinuese nga institucionet qendrore të Kosovës;
- vendosja e një marrëveshjeje për juridiksionin mbi pronat në pronësi shoqërore në Kosovë, e cila, sipas të anketuarve, është pronë e Republikës së Serbisë (kapacitetet e furnizimit me energji dhe ujë të liqenit të Ujmanit, TC Obiliq, PK Malet e Sharrit et.);
- përcaktimi i kriterëve objektive për ofrimin e ndihmës për komunitetin serb në Kosovë nga Republika e Serbisë, gjë që do t'i jepte fund praktikës së shpenzimeve të pajustificuara dhe irracionale të granteve financiare të cilat, siç kanë thënë vazhdimisht grupet e fokusit, "përfundojnë në duar të gabuara";
- përfaqësim më të mirë të gjuhës serbe në Kosovë, posaçërisht në institucione;
- sigurimi i një hapësire më të madhe për pjesëmarrjen e serbëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal dhe qendror;
- shtetësi automatike e dyfishtë për anëtarët e komunitetit serb në Kosovë;
- funksionim i papenguar në Kosovë i sistemit shëndetësor në kuadër sistemit të Serbisë;
- mbrojtja e plotë kushtetuese dhe ligjore e serbëve nga shumica shqiptare;
- formimi i Asociacionit të Komunave Serbe me kompetenca ekzekutive dhe marrëdhënie të veçantë me Serbinë.

Sipas rezultateve të mbledhura përmes sondazhit, prioritetet e qytetarëve të anketuar për vazhdimin e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës nuk ndryshojnë dukshëm në lidhje me reagimet e mbledhura nga fokus grupet dhe intervistat. Të katër temat që morën mbështetje nga rreth ose më shumë se gjysma e të anketuarve përputhen me tre prioritetet kryesore të theksuara gjatë grupeve të fokusit dhe intervistave. Temat e tjera të ofruara morën shumë më pak mbështetje në mesin e të anketuarve, ndër të cilat mbizotëron ideja e formimit të Asociacionit të Komunave Serbe. Përveç kësaj,

Grafiku 5. Temat me rëndësi të madhe për vazhdimin e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës



është e rëndësishme të theksohet se prioritetet për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës dhe institucioneve të buta, si dhe forcimi i bashkëpunimit ekonomiko-infrastrukturor dhe mjedisor, në mesin e të anketuarve u potencuan si të rëndësishme.

Shkëmbimi i territorit

Gjatë periudhës së hulumtimit, kryesisht midis të anketuarve që jetojnë në jug të lumit Ibër, është vërejtur frika nga një demarkacion i mundshëm. Përkundër faktit se asnjë nga palët negociuese nuk u shpjegoi qartë qytetarëve se çfarë do të thotë në të vërtetë plani i ndryshimeve territoriale, të anketuarit shprehën një farë ankthi në lidhje me skenarin e mundshëm që ka qenë në qendër të vëmendjes për dy vite e gjysmë. A janë përdorur për një zgjidhje të mundshme të statusit të Kosovës formulimet si *p.sh. shkëmbim i territorit, demarkacioni, korigjimet e kufijve* ose të ngjashme, bashkëbiseduesit kundërshtuan hapur zbatimin e ndonjë plani jo-transparent që do të dëmtonte të gjithë komunitetin serb në Kosovë.

Për të intervistuarit në jug të lumit Ibër, çdo lloj skenari i ngjashëm paraqet një hap të fundit drejt pavarësisë së plotë të Kosovës dhe një ulje të konsiderueshme të të drejtave të garantuara me kushtetutë dhe ligje për pjesëtarët e këtij komuniteti. Për më tepër, siç u theksua, demarkacioni i mundshëm i cili do të zbatohet me vendosjes e kufirit në lumin Ibër do të destabilizonte edhe më tej "unitetin e popullit serb në Kosovë" dhe procesi i dëbimit të serbëve që jetojnë në jug të lumit Ibër nga Kosova do të përshpejtohej në mënyrë drastike. Sipas aktivistëve të shoqërisë civile nga komuna e Graçanicës, kjo ide është "një pasojë e mos pyetjes së serbëve nga Kosova për procesin e dialogut". Nëse do të pyeteshin, do të ishte e qartë për të gjithë se sa e pakuptimtë është ajo ide. Serbët mbijetojnë në Kosovë vetëm sepse e konsiderojnë veten pjesë të Republikës së Serbisë. Çdo ndryshim do të çonte në emigrimin e popullatës serbe. Ky status, edhe pse u jep atyre një ndjenjë pasigurie, përsëri ofron një lloj sigurie, dhe kjo është ajo që i mban ata këtu. Nëse të drejtat e serbëve

nuk respektohen në kushte të tilla, vetëm mund ta imagjinojmë se si mund të jetë në rastin e demarkacionit".

Pikëpamje krahasimisht të ndryshme u shprehën nga një numër i vogël individësh, veçanërisht midis ekspertëve të intervistuar dhe pjesëmarrësve individualë të grupeve të fokusit nga veriu, se demarkacioni, nga njëra anë, do të bazohej në faktin se komunat në veri nuk u integruan plotësisht në sistemi i Kosovës, dhe nga ana tjetër, kjo ide do të ishte e legjitime nëse Serbisë "do t'i kthehej territori që ishte aneksuar rajonit autonom të Kosovës në vitin 1959." Sidoqoftë, përkundër pranisë së qëndrimeve të kundërta me ato të shprehura nga shumica e pjesëmarrësve, gjatë hulumtimit u vërejt se në mesin e të gjithë të anketuarve ekziston frika e një ndryshimi të mundshëm në *status quo* të shprehur në unitetin e integritetit territorial të Kosovës, i cili, megjithëse është i brishtë, përsëri përfaqëson një "kornizë të qëndrueshme dhe relativisht stabile për mbijetesën e serbëve të Kosovës". Emëruesi më i ulët i përbashkët i pikëpamjeve të të anketuarve për demarkacionin u përmblodh nga një prej ekspertëve të intervistuar: "Kjo është një temë disi e harruar. Por çdo lloj demarkacioni i tillë do të nënkuptojë gjithashtu kolapsin e komunitetit serb në jug të Ibrit. Mendoj se tashmë kemi procese serioze të zhvendosjes së popullatës serbe në Kosovë në jug të Ibrit dhe një demarkacion i mundshëm në natalitetin e popullatës serbe do të kishte një ndikim shumë negativ".

Statusi përfundimtar apo marrëveshja përfundimtare?

Bashkëbiseduesit janë unanimë se statusi përfundimtar i Kosovës nuk duhet të jetë një prioritet për palët negociuese dhe se një zgjidhje për statusin përfundimtar nuk duhet të arrihet në këtë moment. Tendencat për të arritur statusin përfundimtar të Kosovës po i shtypin çështje teknike që aktualisht kanë një rëndësi shumë më të madhe sesa çështja e statusit. Për këtë arsye, të anketuarit besojnë se kthimi i dialogut në nivelin teknik tani është një domosdoshmëri, sepse shumë më tepër gjëra janë rënë dakord dhe zgjidhur në atë nivel sesa tani, kur



Besoj se ruajtja e statusit aktual është më e mira për serbët nga Kosova. Bisedimet duhet të zhvillohen në nivel teknik dhe problemet konkrete që shqetësojnë njerëzit duhet të zgjidhen, pa diskutuar statusin, sepse pikat e fillimit të serbëve dhe shqiptarëve janë krejtësisht të ndryshme në atë aspekt, kështu që një marrëveshje përfundimtare për statusin është e pamundur pa qenë njëra palë plotësisht e pakënaqur. Besoj se një marrëveshje përfundimtare që përfshin çështjen e statusit nuk do të arrihet. Për problemet e një natyre teknike duhet patjetër të diskutohet.

aktivist

dialogu është ngritur në nivelin më të lartë politik. Sipas ekspertëve, bazuar në atë që palët negociuese u paraqesin qytetarëve dhe bazuar në informacionin e disponueshëm përmes mediave, në të ardhmen e afërt nuk do të ketë marrëveshje për zgjidhjen përfundimtare të statusit. Për momentin është e mundur vetëm të formohen grupe teknike, të cilat do të adresojnë problemet kryesore të hasura nga serbët dhe komunitetet e tjera në Kosovë. Nëse ofrohet një propozim për një zgjidhje përfundimtare të çështjes së Kosovës, ai propozim do të imponohet, domethënë nuk do të rezultojë në një marrëveshje të drejtpërdrejtë midis Beogradit dhe Prishtinës. Çdo zgjidhje e imponuar vetëm do të përkeqësonte situatën midis serbëve dhe komuniteteve të tjera në Kosovë, kështu që konsiderohet se është shumë më mirë të qëndrohet kështu, sesa të pranohen zgjidhjet e imponuara, nga të cilat nuk përfiton asnjë komunitet. Pikërisht nga frika e zgjidhjeve të imponuara që, siç u vu re gjatë hulumtimit, lindë një distancë e theksuar drejt ideve të një marrëveshje përfundimtare midis palëve negociuese. Argumenti kryesor në mbështetje të këtij pretendimi të shumicës absolute të të anketuarve është fakti se njohja e pavarësisë së Kosovës do të dëmtonte jetën e serbëve në Kosovë dhe

automatikisht ndërpret lidhjet midis këtij komuniteti dhe Serbisë (kryesisht të institucioneve të buta që veprojnë në Kosovë).

Shqetësimi i komunitetit për një marrëveshje të mundshme përfundimtare është gjithashtu produkt i pikëpamjes së përhapur se status quo-ja e tanishme është një alternativë më e mirë për zgjidhjet e imponuara. Sipas të anketuarve, situata aktuale e serbëve dhe kushtet në të cilat ata jetojnë në Kosovë janë "larg kushteve ideale", por që rrethana të tilla nuk çojnë në një eksod masiv të këtij komuniteti nga Kosova. Megjithatë, në të kundërt, disa ekspertë të intervistuar besojnë se një marrëveshje e mundshme gjithëpërfshirëse nuk ka gjasa të kontribuojë në një përkeqësim të ndjeshëm të kushteve të jetesës për serbët e Kosovës. Për më tepër, siç theksoi njëri prej tyre: "Një marrëveshje e mundshme do të shmangte njohjen zyrtare të pavarësisë së Kosovës nga Serbia, por do të zhbllokonte Kosovën ndërkom-bëtarisht dhe do të mundësonte anëtarësimin e saj në KB." Në kthim, një AKS do të formohej, do të përcaktohet një status i veçantë për trashëgiminë kulturore serbe dhe do të rregullohen të drejtat pronësore mbi ndërmarrjet në zonat me shumicë serbe.

Pozicionimi i komunitetit serb të Kosovës në procesin e dialogut: përjashtimi dhe keqkuptimi?

Për bashkëbiseduesit, procesi i dialogut, përkatësisht implementimi i marrëveshjeve të nënshkruara nuk ishte një proces i rëndësishëm, deri në momentin kur filloi integrimi i serbëve në institucionet e Kosovës, pra kur procesi i implementimit u iniciua në terren. Në atë kuptim, u theksua se ky proces ishte kryer që nga fillimi pa u konsultuar me popullatën lokale, dhe ndryshimet e papritura erdhën si një "befasi e pakëndshme". Për më tepër, frika dhe pafuqia përballë ndryshimeve të afërta mbizotëruan te serbët në veri të Kosovës (në fillim), mbi të cilët ata nuk kishin ndonjë ndikim të rëndësishëm. Në atë kuptim, u theksua se popullata lokale ishte e zemëruar me Beogradin, por edhe me Brukselin



Serbët e Kosovës janë viktima nga të cilat Beogradi pret ta mbrojë sovranitetin e Serbisë në terren, ndërsa Prishtina i shikon ata si një element i huaj dhe qytetarë të klasit të dytë. Mendoj se statusi i tyre do të jetë pjesë e dialogut, jo për shkak të shqetësimeve për mbijetesën e tyre, por sepse ndërmjetësit e dialogut shohin në "statusin" e tyre mundësinë e një marrëveshjeje dhe arritjen e një kompromisi midis Beogradit dhe Prishtinës.

politikolog nga Beogradi

dhe Prishtinën, sepse (posaçërisht serbët në veri të Kosovës) praktikisht u bënë "një monedhë ujdje në lojën e lojtarëve të mëdhenj".

Procesi i zbatimit të marrëveshjeve të arritura gjatë dialogut ka ndikuar ndjeshëm në jetën e serbëve në veri të Kosovës, por edhe të atyre që jetojnë në jug të lumit Ibër, si kolektivisht ashtu edhe individualisht. Njëri nga bashkëbiseduesit perceptimin kolektiv të ndikimit të dialogut në komunitetin serb e përmbledhi me dy fjalë: izolim dhe stigmatizim, si nga Beogradi ashtu edhe nga Prishtina. Megjithëse, në nivel personal dhe kolektiv pas procesit të integritit kishte një masë të caktuar (por dukshëm të kufizuar) të konsolidimit të situatës së sigurisë në veri, pjesëmarrësit njëzëri ranë dakord se integrimi institucional ndikoi negativisht në popullatën lokale - e ardhmja e pasigurt dhe mosbesimi në (dualizmin) e institucioneve (në veri të Kosovës). Duke pasur parasysh që procesi i integritit (institucional-administrativ) në jug të lumit Ibër filloi para Marrëveshjes së Brukselit, dhe se serbët atje jetojnë në mjedise specifike multi-etnike, përfshirja në punë brenda sistemit të Kosovës nuk u shoqërua me një shkallë më të madhe të rezistencës. Në atë kuptim, gjatë aktivitetëve kërkimore, u vërejt se ekziston një mospërputhje e pjeshme midis qëndrimeve të të anketuarve në jug dhe në veri të lumit Ibër. Sidoqoftë, emëruesi i përbashkët i pikëpamjeve të tyre bie në perceptimin e ngulitur



Interesat e serbëve të Kosovës definitivisht nuk ishin të përfaqësuar. Të dyja palët ishin përqendruar ekskluzivisht në interesa "të mëdha" politike dhe askush nuk merrej me gjëra që prekin në mënyrë specifike jetën e serbëve, jetën e përditshme. Për më tepër, gjatë bisedimeve, si atëherë ashtu edhe tani, nuk kishte prani të qëndrueshme dhe të vazhdueshme të përfaqësuesve autentikë serbë nga Kosova.

politikolog nga një prej komunave me shumicë serbe në jug të lumit Ibër

dhe të kudondodhur të ndikimit negativ që bisedimet e Brukselit kanë pasur në jetën e të gjithë komunitetit serb në Kosovë. Ekspertët janë të bindur se qëllimi indirekt i dialogut është në të vërtetë "të prishë lidhjet e drejtpërdrejta midis serbëve dhe Beogradit zyrtar".

Një analizë më e thellë e qëndrimit të përgjithshëm negativ midis të anketuarve ndaj procesit të dialogut përcaktoi se pjesëtarët e komunitetit më të madh jo-shumicë në Kosovë ishin të irrituar nga përjashtimi nga pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe përfaqësimi gjatë bisedimeve të ndërmjetësuar midis Prishtinës dhe Beogradit. Duke shpjeguar pikëpamjet e tyre negative në lidhje me dialogun, u shprehën se interesat e serbëve të Kosovës nuk ishin përfaqësuar sa duhet dhe në mënyrë adekuate gjatë procesit të bisedimeve, sepse gjatë tyre nuk kishte konsultime më të hollësishme dhe serioze me popullatën lokale. Si rrjedhojë, nevojat dhe interesat e tyre autentikë nuk janë përm-bushur ose marrë parasysh. Anketa e realizuar tregoi se **47.7%** e të anketuarve besojnë se ekipi negociator serb nuk ishte i interesuar të dëgjonte pikëpamjet e serbëve nga Kosova, ndërsa **30.5%** e të anketuarve nuk ishin dakord me këtë qëndrim. Kurse **16.2%** e të anketuarve shprehën një pozicion neutral për këtë çështje.

Për shumicën e pjesëmarrësve në hulumtim, problemi thelbësor qëndron në faktin se "deri më tani gjithçka është bërë në fshehtësi". Siç është thënë nga disa bashkëbisedues nga veriu, një shembull i qartë i një trajtimi të tillë mund të gjendet në shembullin e punës jo transparente të Fondit për Zhvillim të Veriut (të formuar gjatë dialogut të Brukselit), qëllimi i të cilit është të ndihmojë në përmirësimin e situatës ekonomike në këtë pjesë të Kosovës. Si një shembull i kësaj qasjeje, një politikolog nga jugu, duke folur për serbët e Kosovës si "subjekt i tregtisë gjatë bisedimeve", tha se "vetë fakti që AKS po negociohet flet për të drejtat e serbëve, dhe fakti se asgjë nuk është arritur në atë fushë tregon se sa të rëndësishme janë të drejtat e serbëve për të gjitha palët" e dialogut të Brukselit. Duke përm-bledhur pozicionin e kolegëve të tij (ekspertëve të intervistuar), aktivisti i sektorit joqeveritar nga veriu arriti në përfundimin se "serbët e Kosovës nuk pyeten për asgjë, por vetëm udhëheqësit shtetëror në Beograd". Prishtina e sheh veriun e Kosovës si një territor, jo si një popullsi, dhe Beogradi e sheh veriun e Kosovës dhe serbët lokalë si një monedhë për ujdj. Në mbështetje të pretendimeve të lartpërmendura dhe qëndrimeve flasin rezultatet e sondazhit të opinionit publik, i cili tregoi se 56.7% e të anketuarve nuk ishin të njohur me përmbajtjen e strategjisë së ekipit negociator serb në bisedimet me Prishtinën.

Përfundimi kryesor që del nga intervistat me të anketuarit është se deri më tani interesat e serbëve të Kosovës nuk janë përfaqësuar në mënyrë adekuate në dialog. Siç u theksua, arsyeja kryesore për këtë është se deri më tani serbët në bisedime nuk kanë pasur një zë autentik dhe se (sipas fjalëve të njërit prej pjesëmarrësve të fokus grupit) "është e vështirë të pritet që Beogradi, i cili fizikisht është larg nesh, të kuptojë dhe të jetë në gjendje të paraqesë të gjitha problemet me të cilat përballet komuniteti serb në Kosovë". Nga perspektiva e popullatës lokale, temat e zgjedhura të bisedimeve të Brukselit nuk adresuan në thelb disa nga problemet kryesore që shqetësojnë serbët. Rrjedhimisht, përpjekja për të zgjidhur problemet teknike nuk krijoi parakushtet për trajtimin e çështjeve (më) të rëndësishme që janë në interes të këtij komuniteti.

4. Rekomandime

Duke u bazuar ekskluzivisht në informatat kthyesë të mbledhura gjatë studimit, u nxorën rekomandime për institucionet kompetente, palët negociuese, akterët ndërkombëtarë dhe akterët e tjerë të rëndësishëm në procesin e bisedimeve midis Prishtinës dhe Beogradit:

- Duke marrë parasysh faktin që **77.7%** e të anketuarve shprehën nevojën dhe domosdoshmërinë për pjesëmarrjen e përfaqësuesve serbë të Kosovës në dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës, është jashtëzakonisht e rëndësishme që ata të përfshihen në vazhdimin e bisedimeve, në mënyrë që nevojat dhe interesat e këtij komuniteti të përfaqësohen, dëgjohen dhe merren parasysh.
- Brukseli, Beogradi dhe Prishtina duhet të bëjnë përpjekje shtesë për të hedhur dritë mbi çështjen e personave të zhdukur, të vrarë dhe të rrëmbyer të të gjitha kombësive, d.m.th. të gjitha viktimat e luftës në Kosovë, si një kusht kyç për ndërtimin e bashkëjetesës dhe fuqizimin e procesit të pajtimit.
- Autoritetet kompetente gjyqësore, qoftë në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, duhet të intensifikojnë ndjekjen penale të atyre që janë përgjegjës për krimet e kryera në periudhën 1998-2004 sa më shpejt të jetë e mundur.
- Të gjitha palët e përfshira në procesin e bisedimeve duhet të intensifikojnë procesin e kthimit të qëndrueshëm të personave të zhvendosur në Kosovë, i cili është në një nivel shumë të ulët.
- Autoritetet gjyqësore të Kosovës dhe Serbisë duhet të krijojnë bashkëpunim dhe komunikim të drejtpërdrejtë për të përshejtuar procesin e zgjidhjes së pronave të uzurpuara në pronësi të serbëve, si dhe përfundimin e procesit të shkëmbimit të shënimeve kadas-trale dhe librave të regjistrimit civil.
- Palët negociuese janë të detyruara të negociojnë dhe zgjidhin problemin e dokumenteve personale, që parandalon pjesëtarët e të gjitha nacionaliteteve në Kosovë të gëzojnë lirinë e lëvizjes. Hapat e parë në atë drejtim do duhej të jetë vazhdimi i targave të regjistrimit KS, por edhe gjetja e një zgjidhje konstruktive në lidhje me njohjen e dokumenteve të lëshuara nga Administrata Koordinuese.
- Bashkimi Evropian, si ndërmjetësi kryesor, duhet të krijojë dhe vendosë mekanizma për monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara dhe të vazhdimin e dialogut ta bëjë më transparent dhe të vë në dispozicion informacionet për të gjithë qytetarët.
- Beogradi duhet të përcaktojë parametrat objektivë për vendimmarrje kur ofron ndihmë për shtresat më të cenuara të komunitetit serb në Kosovë, gjë që do të mënjanonte shpenzimet irracionale dhe shpërndarjen e paarsyeshme të granteve financiare dhe t'u ndihmonte atyre që kanë më shumë nevojë për to.
- Prishtina të mundësojë pjesëmarrje reale, dhe jo vetëm deklarative, të serbëve të Kosovës në proceset vendimmarrëse në nivelin lokal dhe qendror, duke respektuar dhe përmirësuar të drejtat e parashikuara për të

gjitha komunitetet jo-shumicë. Në atë kuptim, është e nevojshme, që ndër ndërhyrjet e para, të sigurohet respektimi i plotë i drejtave gjuhësore dhe të drejtës së patjetërsueshme të pronës private (dhe mbrojtja nga uzurpimi ekzistues dhe i mundshëm i saj).

- Është e nevojshme të krijohen mekanizma të qëndrueshëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe, bazuar në mekanizmat që do të jenë fryt i një marrëveshje midis Beogradit dhe Prishtinës.
- Bashkimi Evropian dhe akterët e tjerë përkatës ndërkombëtarë duhet të pengojnë dhe distancohen nga mbështetja e idesë së demarkacionit. Prishtina dhe Beogradi duhet të informojnë publikisht qytetarët për mosekzistimin e bisedimeve jo transparente që do të çonin në një skenar të tillë.
- Beogradi dhe Prishtina, sipas parimeve të Marrëveshjes së Uashingtonit për përgatitjen e një studimi mbi përdorimin e kapacitetit të Liqenit të Ujmanit, duhet të bien dakord për juridiksionin mbi pronën shoqërore në Kosovë, për të cilën ka mosmarrëveshje që ndalon përparimin ekonomik dhe shoqëror.
- Asociacioni i komunave serbe duhet të formohet në përputhje me nevojat e serbëve të Kosovës, por vetëm në konsultim me popullatën lokale dhe me parimet e vendosura dhe të dakorduara për formimin e tij.
- Dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit duhet të mbahet vazhdimisht dhe të mos ndërpritet. Hulumtimi tregoi se deri në dy të tretat e të anketuarve (66.6%) konsiderojnë se dialogu



Duke marrë parasysh faktin që **77.7% e të anketuarve** shprehën nevojën dhe domosdoshmërinë për pjesëmarrjen e përfaqësuesve serbë të Kosovës në dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës, është jashtëzakonisht e rëndësishme që ata të përfshihen në vazhdimin e bisedimeve, në mënyrë që nevojat dhe interesat e këtij komuniteti të përfaqësohen, dëgjohen dhe merren parasysh.

midis Beogradit dhe Prishtinës është i domosdoshëm për të përmirësuar cilësinë e jetës së serbëve në Kosovë, gjë të cilën BE-ja nuk duhet ta neglizhojë.

- Asociacioni i komunave serbe duhet të formohet në përputhje me nevojat e serbëve të Kosovës, por vetëm në konsultim me popullatën lokale dhe me parimet e vendosura dhe të dakorduara për formimin e tij.
- Dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit duhet të mbahet vazhdimisht dhe të mos ndërpritet. Hulumtimi tregoi se deri në dy të tretat e të anketuarve (**66.6%**) konsiderojnë se dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës është i domosdoshëm për të përmirësuar cilësinë e jetës së serbëve në Kosovë, gjë të cilën BE-ja nuk duhet ta neglizhojë.

Rreth nismës

"Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - Open" është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Open zbatohet në bashkëpunim me nëntë organizata të shoqërisë civile që veprojnë në komunitetin serb në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i nismës së re është të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

- Nisma do të adresojë në mënyrë specifike analizën dhe vlerësimin e ndikimit të organizatave civile dhe politike mbi demokracinë dhe hapjen e komunitetit serb në Kosovë.
- Do të analizohen dhe vlerësohen demokracia dhe hapja e institucioneve, politikat publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.
- Këto analiza do të ndihmojnë për të kuptuar gjendjen aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj qytetarëve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Organizatave me përvojë dhe të dëshmuara të shoqërisë civile, për të arritur qëllime të përgjithshme dhe specifike do të realizojnë tetë (8) analiza sektoriale.

Fushat që partnerët tanë do të analizojnë në vitin 2020 janë:

Mediat Sa ndikojnë mediat në gjuhën serbe në Kosovë në shkallën e hapjes, qasjes dhe pluralizmit të opinionëve dhe temave? Kjo fushë hulumtohet nga **Qendra Mediale** dhe **Bota bardh e zi**.

Shoqëria civile Si kontribuojnë organizatat e shoqërisë civile në hapjen dhe demokracinë e komunitetit serb dhe shoqërisë në Kosovë në përgjithësi? Me këtë temë merret **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Partitë politike Demokracia dhe pluralizmi i partive politike serbe të Kosovës, hapja e tyre për të marrë pjesë në sistemin politik të Kosovës dhe për të kontribuar në avancimin dhe përmirësimin e politikave publike. Në këto çështje do të fokusohet **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Qendra Mediale**

Përgjegjësia e institucioneve Përmes monitorimit të kuptohet më mirë pozita e komunitetit serb në Kosovë dhe se sa të hapur janë institucionet ndaj problemeve të serbëve. Analiza realizohet nga **Bota bardh e zi** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Siguria Sa ndikon ndjenja e sigurisë në hapjen e komunitetit serb ndaj institucioneve të sigurisë së Kosovës? Në këtë pyetje kërkon përgjigje **Qendra Humane Mitrovica**.

Ekonomia Sa janë të hapura entitetet ekonomike nga komunitetet me shumicë serbe për integrim në ekonominë e Kosovës? Këtë fushë e analizon **Instituti për Zhvillimin Ekonomik Territorial (InTER)**.

Të drejtat e pakicave Si të arrihet një shoqëri më e hapur duke vënë në pah boshllëqet në zbatim të së drejtave të pakicave? Kjo temë shqyrtohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave**

Procesi i dialogut dhe normalizimi i marrëdhënieve

Kosovë-Serbi - Deri në çfarë mase përfaqësohet dhe cilat janë qëndrimet e komunitetit serb të Kosovës lidhur me ndikimin dhe të ardhmen e procesit? Kjo analizë realizohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Në fund të ciklit Open 2020 do të publikohet raporti i konsoliduar „**Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës**“ duke i vendosë rezultatet dhe përfundimet e analizave bazë të anëtarëve të iniciativës Open në një kontekst më të gjërë socio-politik të Kosovës.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

